



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.83

2004

18 nëntor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.699, datë 22.10.2004	Për “Miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në konstruksionet dhe ndërtimet, që shërbejnë për veprimtari akomoduese turistike”.....	6189
Urdhër i MBU nr.481, datë 9.11.2004	Për një ndryshim në urdhrin nr.98, datë 26.2.2004 “Për tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të sistemit të bujqësisë dhe të ushqimit”.....	6230
Urdhër i MBU nr.482, datë 9.11.2004	Për tarifat e shërbimeve që kryhen nga seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark.....	6230

VENDIM
Nr.699, datë 22.10.2004

**PËR “MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE
PËR SHPËTIMIN NË KONSTRUKSIONET DHE NDËRTIMET, QË SHËRBEJNË PËR
VEPRIMTARI AKOMODUESE TURISTIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, me propozim të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit dhe të Ministrit Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në konstruksionet dhe ndërtimet, që shërbejnë për veprimtari akomoduese turistike, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Personat fizikë ose juridikë, që hartojnë projekte për ndërtimin e objekteve, publike ose private, të zbatojnë rregullat teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, të miratuara sipas këtij vendimi.

3. Këshillat e rregullimit të territorit të miratojnë lejet e ndërtimit, vetëm pasi të jetë parashikuar plotësimi i normave dhe kushtet teknike të mbrojtjes nga zjarri, në përputhje me rregullat teknike, të miratuara në këtë vendim.

4. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për kontrollin e zbatimit e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**RREGULLAT TEKNIKE PËR PARANDALIMIN E ZJARREVE NË KONSTRUKSIONE,
NDËRTIME, ME AKTIVITET AKOMODUES TURISTIK**

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. OBJEKTI

Miratimi i rregullave dhe normave teknike për parandalimin e zjarreve ka si qëllim mbrojtjen e personave dhe të mirave materiale nga rrezja e zjarreve dhe ka për objekt kriteret e sigurisë, për t'u aplikuar në konstruksionet ose ndërtesat e përshtatura për aktivitetet akomoduese turistike, të përcaktuara në akte nënligjore dhe të renditura si më poshtë:

- a) hotele;
- b) motele;
- c) fshatra hotelesh;
- d) fshatra turistikë;
- e) rastet e dhënieve të apartamenteve me qira;
- f) shtëpi dhe apartamente të destinuara për pushime;
- g) qendra agroturistike;
- h) rezidenca turistike;

- i) kampe alpine;
- j) qendra rezidenciale-turistike për të rinj;

2. FUSHA E APLIKIMIT

Kjo rregullore aplikohet për konstruksionet, ndërtesat dhe objektet e sipërcituara në pikën 1, për ato objekte që janë ekzistuese ose që do të ndërtohen të reja në të ardhmen. Për ndërtesat ekzistuese, që merren me aktivitete akomoduese turistike, aplikohen dispozitat e parashikuara për ndërtesat e reja, si dhe për rastet e rikonstuksionit të tyre me mbi 50% të vlerës.

Në aktivitetet respektive ekzistuese, kjo rregullore është e aplikueshme kur kërkohet një rritje të kapaciteteve akomoduese, kur sistemi i rrugëve të shpëtimit ekzistues është i përputhshëm me popullimin, si dhe me sistemin e ri plan-volumetrik të aktivitetit. Për këtë rast, mund të aplikohet kreu II pjesa II e rregullores.

3. KLASIFIKIMI

Aktivitetet akomoduese, për të cilat bëhet fjalë në pikën 1, në lidhje me kapacitetet akomoduese, numri i shtretërve në dispozicion të të pranishmëve të ftuar ose pushues të ndërtesës ose lokaleve (ndarjeve), që bëjnë pjesë në këto njësi ndahen në:

- a) aktivitete akomoduese me një kapacitet më të madh se 25 shtretër, për të cilat aplikohen përshkrimet e kreut II;
- b) aktivitete akomoduese me kapacitet deri në 25 shtretër, për të cilat aplikohen përshkrimet e kreut III.

Për kampet alpine aplikohen përshkrimet në kreun IV.

4. TERMA, PËRCAKTIME DHE TOLERANCA DIMENSIONALE

Për termat, përcaktimet dhe tolerancën dimensionale i referohemi sa është përcaktuar në dispozitat e mëparshme.

Hapësirë e qetë: vend i sigurt statik (i ngjitur) dhe komunikues me një rrugë braktisjeje vertikale ose në të i përfshirë. Një hapësirë e tillë nuk duhet të jetë në përbërje të rrugëve të evakuimit dhe duhet të ketë karakteristika të tilla për të garantuar qëndrimin e personave.

Korridor i verbër: korridor ose pjesë korridori, në të cilën është i mundshëm evakuimi në një drejtim të vetëm. Gjatësia e korridorit të verbër llogaritet nga fillimi i tij deri në fund të kryqëzimit me një tjetër korridor, ku është i mundshëm evakuimi në dy drejtime, deri në vendin më i afërt e të sigurt, deri tek rruga e evakuimit vertikal.

Kufiri i qëndrueshmërisë ndaj zjarrit: është koha në minuta nga fillimi i provës në qëndrueshmëri, kundrejt zjarrit sipas një regjimi të përcaktuar të temperaturave, deri në humbjen e qëndrueshmërisë të përbërësve kryesorë të elementëve të strukturave.

Materiale të padjegshme: nën ndikimin e zjarrit, ose të temperaturave të larta nuk flakërohen, nuk digjen, nuk karbonizohen.

Materiale vështirësisht të djegshme: nën ndikimin e zjarrit, ose të temperaturave të larta flakërohen me vështirësi, digjen ose karbonizohen dhe vazhdojnë të digjen vetëm në prani të burimit të zjarrit.

Materiale të djegshme: nën ndikimin e zjarrit, ose të temperaturave të larta flakërohen, digjen pa flakë dhe vazhdojnë të digjen edhe pas heqjes së zjarrit.

R: rezistenca e pjesëve të jashtme të objektit ndaj zjarrit shprehur në minuta (0-120 minuta).

REI: rezistenca e pjesëve të brendshme të objektit shprehur në minuta (0-120 minuta).

RE: rezistenca e dyerve të dhomave, kjo e fundit e shprehur në minuta.

Lartësia antizjarr: lartësia e objekteve e shprehur në metra, me ndarje të tillë: 0-24 metër, 24-54 metër, mbi 54 metër.

Rezistenca e materialeve ndaj zjarrit e përcaktuar sipas klasave:

KLASA 0: materiale të padjegshme;

KLASA 1: materiale vështirësisht të djegshme;

KLASA 2: materiale të djegshme.

KLASA 1 IM: materiale, pajisje për mobilim, që kanë si përbërës lëndë të tilla si dru+përbërësit e pambukut, leshit etj, si dhe nënproduktet e tyre dhe përdoren për mobilimet të brendshme.

Me termin "OBJEKT"-LOKAL, ose pjesë objekti, lokali: kuptohet një hapësirë me volum të përcaktuar, e ndarë plotësisht ose pjesërisht nga mjedisi i jashtëm, ose nga ambiente të tjera fqinje, nëpërmjet pareteve/mureve.

KREU II

DISPOZITAT RELATIVE NË AKTIVITETE AKOMODUESE TURISTIKE ME KAPACITET MË TË MADH SE 25 SHTRËTËR

PJESA E PARË

AKTIVITETET NË NDËRTESAT E REJA

5. VENDNDODHJA

5.1. Të përgjithshme

Ndërtesat e destinuar për aktivitetet akomoduese turistike, vendosen në mënyrë të tillë, ku respektohen distancat e sigurisë, të përcaktuara nga dispozitat në fuqi, distancat që kërkohen nga aktivitetet e tjera, që sjellin rreziqe shpërthimesh nga zjarret. Aktivitetet akomoduese mund të jenë vendosur:

a) në ndërtesa të ndara e të ndërtuara, për një specifikë të tillë të parashikuar në rregullore dhe të izoluar nga të tjerat.

b) në ndërtesa ose objekte që janë në vazhdim, ose ndërtesa të tjera me destinacione të ndryshme, por duke pasur parasysh normat specifike, këto destinacione i nënshtrohen kontrolleve të strukturave të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin, siç përcaktohet në dispozitat në fuqi.

5.2 Ndarjet, komunikimi

Duke marrë në konsideratë sa është përcaktuar në rregullat teknike, aktivitetet akomoduese turistike:

a) nuk mund të komunikojnë me aktivitetet që nuk i përkasin atyre;

b) mund të komunikojnë direkt me aktivitetet që u përkasin atyre, por që nuk janë subjekt i kontrolleve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin;

c) mund të komunikojnë nëpërmjet filtrave të provës të tymit ose hapësirave të zbuluara me aktivitetet e lejuara, subjekt i kontrolleve të strukturave të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin;

d) duhet të jenë të ndara nga aktivitetet e treguara në germën "a" dhe "c" të kësaj pike, nëpërmjet strukturave të karakteristikave të paktën me rezistencë të pjesëve të brendshme të ndarjeve ndaj zjarrit 90 minuta (REI 90).

5.3 Hyrja në zonë

Për të lejuar ndërhyrjen e shërbimit zjarrfikës me (automjete) të PMNZSH-së, hyrjet në zonat ku ngrihen ndërtesat, objekt i kësaj rregulloreje, duhet të plotësohen këto kushte specifike minimale:

- gjerësia: 3,50 m;

- lartësia e lirë: 4 m;

- rrezja e kthimit: 13 m;

- pjerrësia: jo më e madhe se 10%;

- rezistenca ndaj ngarkesës: të paktën 20 tonë (8 mbi aksin e përparëm, 12 mbi aksin e pasëm, hapi 4 m).

5.4 Afrimi i mjeteve të shpëtimit

Për strukturat akomoduese turistike të vendosura në lartësinë mbi 12 metër, duhet të sigurohet mundësia e afrimit të automjeteve autoshkallë, të paktën nga njëra anë, me qëllim që të arrihet nëpërmjet dritareve dhe kalimeve të brendshme në kate, në objekte të ndryshme. Në rastet kur kjo kërkesë nuk është plotësuar, ndërtesat me lartësi mbi 12 metër duhet të kenë vendosur shkallë shpëtimi për evakuim, e cila më poshtë emërtohet “shkallë të provës së tymit”.

6. KARAKTERISTIKAT KONSTRUKTIVE

6.1 Rezistenca ndaj zjarrit e strukturave

Kërkesat e rezistencës ndaj zjarrit të elementeve strukturale, duhet të vlerësohen në bazë të përshkrimeve dhe modaliteteve të provës, të vendosura nga dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore, në varësi të tipit të materialit të përdorur, në realizimin e elementeve të ndërmjetme (beton, çelik, dru masiv, dru i laminuar, elementë përbërës, etj.).

Elementet strukturore duhet të jenë të njohura ligjërisht në një nga vendet e Komunitetit Europian, në bazë të normave të harmonizimit ose të normave dhe rregullave teknike të huaja të njohura, ekuivalente nga vende kontraktuese të markave CEE, të cilat mund të tregtohen në vendin tonë. Për këtë qëllim, përdoruesi për secilin prototip duhet të disponojë certifikatat e cilësisë, situatë që motivon aprovimin ose mosaprovimin e materialeve.

Këto instanca, për të cilat bën fjalë paragrafi i mësipërm, duhet të kenë dokumentacionin e nevojshëm për indentifikimin e produktit, certifikatave relative të provës, të lëshuara ose të rinjohura nga organet kompetente të shtetit unitar të Komunitetit Europian, ose nga vende të tjera jashtë tij.

Dimensioni i spesorëve dhe i mbrojtjeve, për t'u adaptuar për tipe të ndryshme materialesh, si dhe klasifikimi i ndërtesave në funksion të ngarkesave të zjarrit, përcaktohen nga përllogaritja e ngarkesave për zjarr, për objekte që kanë struktura mbrojtëse prej druri.

Kërkesat e rezistencës ndaj zjarrit të dyerve dhe elementeve të tjera mbyllëse vlerësohen dhe certifikohen në bazë të dispozitave të parashikuara në akte nënligjore të veçanta të këtyre elementeve.

Strukturat mbrojtëse duhet të garantojnë rezistencën ndaj zjarrit (R) dhe strukturave ndarëse në to (REI) (rezistenca e pjesëve të brendshme të objektit ndaj zjarrit) në bazë të tabelës së mëposhtme:

Lartësia antizjarr	R	REI
Deri 24 m	60	60
Mbi 24 m deri në 54 m	90	90
Mbi 54 m	120	120

Për strukturat në lidhje me zonat me rrezik specifik të shtuar, duhet të aplikohen dispozitat e vendosura në norma nënligjore respektive të veçanta për to.

6.2 Reaksioni i zjarrit ndaj materialeve

Materialet e instaluar në strukturat akomoduese turistike duhet të kenë koeficientët specifikë si më poshtë:

a) në ambiente, në korridore, në shkallë, në sheshpushime shkallësh, në kalimet në përgjithësi, lejohet përdorimi i materialeve të klasës 1, në masën 50% të maksimumit të sipërfaqes së tyre totale (dysHEME + tavane + parete + projektimi horizontal i shkallëve), kurse për pjesën e mbetur duhet të përdoren materiale të klasës 0, jo të djegshme;

b) në të gjitha ambientet e tjera lejohet që dyshemetë, duke përfshirë dhe riveshjet e tyre, të jenë të klasit 2 dhe të gjitha materialet e tjera të riveshjes të jenë të klasit 1, ose dhe të klasit 2 në qoftë se ka impiante të shuarjes automatike, ose të sistemeve të filtrimit të tymrave, të asistuar nga sisteme të zbulimit të zjarreve.

c) materialet e riveshjes së djegshme, si dhe materialet izoluese për të cilat bën fjalë germa “f” e mëposhtme, të shpërndara nëpër klasa të ndryshme të reaksionit të zjarrit duhet të përdoren si elemente konstruktive të klasit 0, duke përjashtuar hapësirat boshe; duke marrë parasysh kufizimet e përshkruara në germën “a” lejohet instalimi, si dhe i materialeve të riveshjes dhe materialeve izoluese, në pamje të vendosura të cilat kanë klasë të reaksionit ndaj zjarrit 1, ose 1-1 dhe janë të homologuara duke pasur parasysh kushtet efektive të përdorimit, në lidhje me burimet e mundshme të lindjes së harkut elektrik;

d) materiale të predispozuara të marrjes zjarr në të dyja anët, si: (tenda, etj.) duhet të jenë të klasës të reaksionit ndaj zjarrit më e madhe se 1;

e) mobiljet dhe dyshekët duhet të jenë të klasës së reaksionit ndaj zjarrit 1 IM;

f) materialet izoluese në pamje, që duken direkt dhe ekspozohen ndaj flakëve duhet të jenë të klasës së reaksionit ndaj zjarrit jo më të madhe se 1; në rastin e materialeve izoluese në pamje me komponentë izolues jo të ekspozuar direkt ndaj flakëve lejohen klasat e reaksionit ndaj zjarrit 0-1; 1-0; 1-1.

Materialet që bëjnë fjalë germa e mësipërme duhet të jenë të homologuara në bazë të dispozitave në fuqi.

Lejohet vendosja në punë e riveshjes prej druri, trajtuar në mënyrë oportune me prodhime të vernikuara, të homologuara të klasës 1 të reaksionit ndaj zjarrit. Materialet izoluese të instaluar në brendësi të ndarjeve duhet të jenë jo të djegshme.

Lejohet instalimi i materialeve izoluese jo të djegshme në brendësi të ndarjeve të realizuara nga struktura me materiale të padjegshme, që kanë rezistencë ndaj zjarrit të paktën REI 30.

6.3 Ndarjet

Ndërtesat duhet të jenë të ndara me nëndarje, sipërfaqja e të cilave nuk duhet t'i kalojë përmasat e tabelës A.

Pranohet se dy kate mbi tokë të ndërtesave përbëjnë një pjesë të vetme të ndërtimit, dhe sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit nuk duhet të jetë më e madhe se 4000 m².

Kati i parë nëntokë, hapësirë e destinuar për të gjithë dhe në shërbim të publikut, lejohet me kusht që kjo sipërfaqe nuk duhet të tejkalojë përmasat 1000 m².

Tabela A

Lartësia antizjarr	Sipërf. Mak e ndarjeve
Nën 24 m	3000 m ²
Mbi 24 m dhe nën 54 m	2000 m ²
Mbi 54 m	1000 (*) m ²

(*) ndarjet lejohen për t'u zgjeruar vetëm në një kat.

6.4 Kate nëntokësore

Sipërfaqja e lirë në shërbim të publikut lejohet të vendoset vetëm deri në kuotat minus (-) 10,00 metër.

Për sa më sipër, zona e vendosur në kuotat -7,50 dhe -10,00 m, duhet të jenë të mbrojtur nga impiante automatike të fikjes së zjarreve me ujë, të ndara dhe të komanduara nga impiante zbulimi dhe sinjalizimi antizjarr.

6.5 Korridoret

Ndarjet e dhomave dhe të korridoreve duhet të kenë karakteristikat e rezistencës ndaj zjarrit jo më vogël se REI 30. Dyert e dhomave duhet të kenë karakteristika të rezistencës ndaj zjarrit REI 30, si dhe të jenë pajisur me udhëzues për rastet e vetmbyljes.

6.6 Shkallët

Karakteristikat e rezistencës ndaj zjarrit për shkallët duhet të përputhet me kërkesat, sa është parashikuar përshkrimet e pikës 6.1.

Shkallët e shërbimit, për ndarjet në më shumë se dy kate mbi tokë, duhet të jenë të tipit të mbrojtur.

Shkallët e shërbimit, për ndarjet në më shumë se gjashtë kate, duhet të jenë të tipit të provës së tymit.

Gjerësia e shkallëve nuk mund të jetë më e vogël se 1,20 metër.

Basamakët e shkallëve duhet të jenë në linjë të drejtë, në mënyrë të tillë, por jo më pak se tri shkallë dhe jo më shumë se pesëmbëdhjetë të tilla. Shkallët duhet të jenë drejtëkëndore, duhet të kenë lartësinë jo më të vogël se 17 cm dhe jo më të madhe se 30 cm. Janë lejuar basamakë shkallësh jo në linjë të drejtë, në kondicione të tilla që janë sheshpushime në çdo pesëmbëdhjetë shkallë. Përmasat e shkallës mund edhe të jenë 30 cm deri në 40 cm të paretit të brendshëm.

Kafazët e shkallëve nuk duhet t'i kenë përmasat e ajrimit më të vogla se 1 m². Në kafazët e ajrimit këshillohet të instalohen dhe të aplikohen dispozitivat për mbrojtjen nga agjentët atmosferikë.

6.7 Ashensorët dhe ashensorët për ngarkesa

Ashensorët, ashensorët për ngarkesa nuk janë të dobishëm për t'u përdorur për rastet e zjarreve, për këtë qëllim bëjnë pjesë ashensorët antizjarr, sipas përcaktimeve të pikës 6.8. Ashensorët dhe ashensorët për ngarkesa, që nuk janë instaluar nga brenda në një shkallë të tipit të mbrojtur, duhet të jenë të tipit me kafaz të mbrojtur, me karakteristikat dhe rezistencat nga zjarri sipas përcaktimeve të pikës 6.1.

Karakteristikat e ashensorëve dhe të ashensorëve për ngarkesa duhet të përputhen me specifikimet e dispozitave në fuqi për parandalimin e zjarreve.

6.8 Ashensorët antizjarr

Në strukturat e objekteve akomoduese turistike me lartësi mbi 54 metër, duhet të vendosen dhe të jenë parashikuar që në projekt ashensor antizjarr, i cili është i dobishëm për rastet e zjarreve në operacione të ndihmës për evakuim të pranishmëve i cili realizohet si më poshtë:

1. Hapësirat e strukturave të këtyre objekteve, ku vendosen këto pajisje duhet të kenë rezistencën ndaj zjarrit REI 120; hyrjet për zbritjet nga katet duhet të kenë kaluar provën filtrave të tymit, me rezistencë ndaj zjarrit REI 120; hyrja në objekte të këtyre pajisjeve duhet të jenë vendosur direkt nga jashtë, nëpërmjet filtrit të provës së tymit, kjo e realizuar me materiale strukturore me rezistencë ndaj zjarrit REI 120;

2. Ashensorët antizjarr ndërtohen në mënyrë të tillë që të kenë dopio sistem ushqimor elektrik, ku njëra është për siguri;

3. Për rastet e zjarreve duhet realizuar kalimi automatik i ushqimit normal dhe i ushqimit për siguri;

4. Në rastet e zjarreve, këta ashensorë i rezervohen personelit të strukturave të shërbimit zjarrfikës dhe atyre të shpëtimit;

5. Montimi i ushqimit elektrik normal, për sigurimin e këtyre objekteve të pajisjeve ashensor antizjarr duhet të jenë të mbrojtur kundër zjarreve dhe të ndara qartë;

6. Ashensorët antizjarr duhet të jenë pajisur me sistem citofonie në kabinë;

7. Për ashensorët antizjarr duhet të parashikohen hapësira të veçanta në këto objekte.

7. PËRMASAT PËR EVAKUIM NË RAST EMERGJENCE

7.1 Përqendrimi i personave

Përqendrimi i personave të caktuar në:

- zona të destinuar për dhoma: sipas numrit të vendeve të shtretërve;

- zona në shërbim të publikut: destinuar për grumbullime për 0,4 persona/m², përcaktuar sipas pikës 8.4.4;

- zona të destinuar për shërbim: persona pranishëm të grumbulluar, më pak se 20%.

7.2 Kapaciteti i daljeve (fluksit)

Në fund të dimensioneve të daljeve, kapacitetet e fluksit të daljeve duhet të jenë jo më të mëdha se vlerat pasuese:

- 50 persona për kate tokësore;
- 37,5 persona për kate nëntokësore;
- 37,5 persona për objekte deri në tre kate;
- 33 persona për objekte mbi tre kate.

7.3 Sistemet e rrugëve të daljes

Për objekte ose pjesë objektesh, që janë të destinuara për veprimtari akomoduese turistike, duhet të jetë i parashikuar rezervë një sistem i organizuar rrugë daljeje, dimensionuar në bazë të maksimumit të fluksit të parashikuar në funksion të kapaciteteve të fluksit, që parashtron një vend i sigurt.

Rrugëkalimet përfshijnë korridoret, hapësirat e shkallëve dhe daljet e jashtme, shkallët, sheshpushimet midis shkallëve etj.

Duhet të jetë parashikuar të paktën një hapësirë e qetë për çdo kat, ku kanë hyrë persona me kapacitet të pakësuar ose të penguar. Hapësirat e qeta duhet të jenë të dimensioneve të ulëta në numër, të dobishme dhe të parashikuara në aktet normative në fuqi.

Largësia e nevojshme duhet të jetë e përmasave të deduksionit të ngarkesës së mundshme, si elemente të dala ekskluzivisht sipas pajisjeve të fikësve të zjarrit.

Ndërmjet elementeve të dala nuk janë konsideruar këto përmasa, lartësia e lejuar është maksimumi 2 m dhe mundësisht druri i paretit të shkallëve nuk duhet të kalojë përmasat mbi 8 cm.

Duhet të evitohet vendosja sipërfaqësore ose e penguar e drejtimit të daljes.

Portat e hyrjes për në shkallë kur hyn nga jashtë, për në vendin e mbrojtur, duhen të jenë të vendosura për t'u hapur në krahun e daljes për jashtë, me një shtyrje të thjeshtë.

Dyert e dhomave për të ftuarit duhet të jenë të pajisura me një bravë që zhblokohet automatikisht nga brenda duke e shtyrë lehtësisht në rast rreziku.

Dyert që hapen në drejtim të rrugëve të daljes duhet të jenë ndërtuar në mënyrë të tillë që të kenë largësinë e nevojshme të po atij drejtimi.

7.4 Gjerësia e rrugëve të daljes

Gjerësia e nevojshme e rrugëve të daljes duhet të jetë shumfishi i modulit të daljeve, por jo më pak se dy dalje për çdo objekt moduli (1,20 m). Përmasat e largësisë së daljes duhet të jenë realizuar në pikën më të ngushtë të dritës.

Bën përjashtim largësia e korridoreve të brendshme në apartamente që ushtrojnë veprimtari akomoduese dhe e dyerve të dhomave.

7.5 Gjatësia e rrugëve të daljes

Nga dyert e çdo dhome, nga çdo pikë e objektit, duhet të jetë e mundur për t'u kapur një dalje, për te vendi i sigurt ose te shkallët e jashtme të sigurisë, me një rrugë të përshkruar, por jo më të gjatë se 40 m.

Është pranuar për objektet deri në 6 (gjashtë) kate, rruga e përshkruar e arritur drejt daljes për në shkallën e mbrojtur, nuk duhet të jetë më shumë se 30 m, me kusht që i njëjti drejtim të futet direkt për në vendin e sigurt.

Gjerësia e korridorit të verbër nuk mund t'i kalojë të 15 m.

7.6 Gjerësia totale e daljeve

Gjerësia totale, në çdo kat, shprehur në numër modulesh, është e përcaktuar nga raporti në mes maksimumit të grumbullimeve parashikuar në kapacitetet e fluksit të kateve.

Për strukturat që kryejnë veprimtari akomoduese dhe që zënë më shumë se dy kate mbi tokë, gjerësia totale e rrugëve të daljes që vendosen në hyrje, vjen e llogaritur duke shtuar maksimumin e grumbullimeve të parashikuara në dy kate pasuese, me referimin e vlerave të mbivendosjes.

Në brendësi të gjerësisë së daljes janë mbështetur portat e hyrjes, kur këto janë të hapshme në drejtim të daljes.

Është e këshillueshme të instalohen këto lloj portash hyrjeje:

a) tip i rrotullueshëm, nëse pranë është instaluar një portë e hapshme, e shtytshme në drejtim të jashtëm me karakteristikat e daljes.

b) tip i rrëshqitshëm me lëvizje automatike, veçanërisht të jenë të hapshme me të shtyrë, kur mungon ushqimi elektrik.

Shkallët e lëvizjes nuk duhet të parashikohen në gjerësinë e daljes.

7.7 Numri i daljeve

Numri i daljeve në ndërtesat njëkatëshe nuk duhet të jetë më pak se dy. Ato shkojnë në mënyrë të tillë që të jenë në krah të kundërt. Është e këshillueshme që ndërtesat me mbi dy kate të jenë të ndërtuara vetëm nga një shkallë e vetme, sepse thëllësia e korridorit që përshkrohet, nuk i kalon 15 m dhe ndalen duke qëndruar në shikimin e pikës 7,5 m në drejtimin e parë.

Në strukturat akomoduese njëkatëshe në të gjitha dhomat që kanë hyrjet direkt me daljet, nuk është e nevojshme realizimi i një daljeje të dytë eksodi brenda zonës së rezervuar të dhomës.

8. ZONA DHE IMPIANTE ME RREZIK TË VEÇANTË

8.1 Objekte të përcaktuara për depozita

8.1.1 Objekte me sipërfaqe jo më të vogël se 12 m², destinuar për magazinimin e materialeve të djegshme

Ndarje të tilla mund të jenë të vendosura edhe në sipërfaqe të brendshme (dhome). Strukturat ndarëse duhet të kenë të paktën karakteristika REI 60, si dhe të jenë të pajisura me pajisje vetkyçëse në raste rreziku. Ngarkesa e flakës duhet të jetë kufizuar në 60 kg/m² dhe duhet të jetë instaluar në të njëjtin automatik diktimi e alarmi për zjarret. Ventilimi natyral nuk duhet të jetë më pak se 1/40 e sipërfaqes të objektit.

Në qoftë se nuk është e mundur të arrihet ajrimi natyral i raportit të mësipërm, realizohen dy ajrime mekanike, në prurjen e dy orareve të garantuara edhe në rastet e emergjencave, deri sa të sigurohet një sipërfaqe ajrimi e barabartë me 25% të asaj të parashikuar.

Pranë dyerve të dhomave, duhet të jetë instaluar një fikëse zjarri.

8.1.2 Objekte me sipërfaqe maksimumi 500 m², destinuar për magazinimin e materialeve të djegshme

Mund të jenë të vendosura edhe në sipërfaqe nëntokësore në brendësi të ndërtesës duke përjashtuar sipërfaqet e dhomave. Strukturat ndarëse duhet të paktën të kenë karakteristika REI 90 dhe të jenë të pajisura me pajisje vetkyçëse për rastet e rrezikut. Ngarkesa e flakës duhet të jetë e kufizuar në 60 kg/m² dhe duhet të jetë instaluar në të njëjtin automatik alarmi për lajmërimin e zjarrit. Ventilimi natyral nuk duhet të jetë më pak se 1/40 e sipërfaqes të objektit.

8.1.3 Depozitat e substancave të lëndëve të djegshme

Duhet të jenë të vendosura në më pak se volumi i fabrikuar. Është e këshillueshme të sistemohen në brendësi të ndërtesës nëpër dollapë metalikë të përshtatur në rezervuarë me lëndë antizjarr, në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare.

Dollapë të tillë duhet të jenë vendosur në objektet magazinë.

8.2 Shërbime teknologjike

8.2.1 Impiante të prodhimit të nxehtësisë

Impiantet e prodhimit të nxehtësisë duhet të jenë të tipit të përqendruar (qendror). Impiante të tilla duhet të jenë realizuar sipas rregullave të përpikta, duke respektuar specifikimet teknike për parandalimin e zjarrit. Në fshatrat turistike dhe në rezidenca me veprimtari akomoduese, është e këshillueshme, sipas destinacionit specifik, që grumbullimet e veçanta të banesave të jenë shoqëruar nga impiante individuale për ngrohje ambienti ose gatimi ushqimesh me gaz djegës, për të mundësuar kontrollin e kushteve të poshtëshënuara:

a) aparatet dhe impiantet e gazit, sipërfaqet e ajrimit dhe kanalizimet e shkarkimeve të gazrave duhet të jenë realizuar sipas rregullave të përcaktuara të përpikta, konform rregullave të sigurisë në fuqi;

b) aparatet e ngrohjes së ambientit dhe të prodhimit të ujit të ngrohtë ushqyer me gaz duhet të vendosen jashtë;

c) çdo vatër djegëse e gazit duhet të jetë e pajisur me dubël saraçineskë për ndërprerjen e fluksit të gazit për rastet e fikjes së flakës;

d) kontaktorët ose bombolat e ushqimit me gaz të djegshëm duhet të jenë vendosur jashtë godinave të përcaktuara në objektin e kësaj rregulloreje;

e) depozitat me gaz të djegshëm për ushqimin e pajisjeve të përdorimit me gaz në objekte, të vendosura mbi sipërfaqen e tokës me kapacitet deri në 3 metër kub, duhet të respektojnë distanca të tilla nga objekti me largësi mbi 7.5 metër; për depozita me kapacitet deri në 5 metër kub, distanca nga objekti nuk duhet të jetë më e vogël se 10 metër largësi (shih përcaktimet e figurës B):

f) bombolat e ushqimit me gaz të djegshëm, që vendosen brenda ndërësive të objektit për pajisjet që ushqehen me gaz mbushen me më pak se 80 % e volumit të fabrikuar, si dhe pesha e tyre nuk duhet t'i kalojë 25 kg;

g) fuqia termike që sjellin aparatet e ushqimit me gaz duhet të jenë kufizuar në vlerën e 34,89 kW (30000 Kcal/h);

h) aparatet duhet të jenë objekt i një mirëmbajtjeje të rregullt dhe instruktimesh edhe për përdoruesit e tyre këto rregulla duhet të jenë të qarta;


i) largësitë e depozitave të gazit të djegshëm nga objektet e tjera që nuk janë objekt i kësaj rregulloreje përcaktohen nga tabela e mëposhtme A dhe nga figura B.

Tabela A dhe figura B paraqesin largësinë midis depozitave sipas madhësisë së tyre në volum dhe llojit të objektit nga objektet e klasifikuara sipas përcaktimeve të pikës 1 të rregullores.

Tabela A

Nr.	Kapaciteti në m ³		Emërtimi i objektit
	3	5	
	10 m	15 m	Shkolla të çdo lloji
	10 m	15 m	Hotele e motele etj.
	10 m	15 m	Kinema, teatro, palestra
	10 m	15 m	Fabrika e punishte
	10 m	15 m	Godina banimi e administrative
	10 m	15 m	Rrugë (nga buza e brendshme e trotuarit)
	15 m	20 m	Hekurudhë (nga buza e trasesë)
	15 m	20 m	Linjë ajrore elektrike
	D1 + D2 2	D1 + D2 2	Midis dy depozitave

Figura B



8.2.1.1 Shpërndarja e gazit të djegshëm

Tubacionet qendrore të gazit të djegshëm duhet të jenë vendosur në pamje të jashtme e të dukshme të ndërtesës. Në alternativë, për rastet e gazit me përqëndrim relativ më të vogël se 0,8, është lejuar sistemimi i drejtë në zonën me pikën më të lartë.

Në objekte duhet pranuar që tubacionet duhet të jenë të reaksionit ndaj zjarrit të klasit zero, me diametër superior të paktën 2 cm, si dhe duke respektuar përmasat e tubacioneve të brendshme.

Tubacionet kryesore të gazit duhet të jenë sipas parametrave të përcaktuar, si dhe me vetmbyllje automatike në situatë rrjedhjeje.

Gjithashtu tubacionet duhet të kenë instaluar sinjalistikë treguese për praninë e gazit.

8.2.2 Impiante të kondicionimit dhe ventilimit

Impiantet e kondicionimit dhe të ventilimit mund të jenë qendrore ose të lokalizuara. Të tilla impiante duhet të kenë të nevojshme respektimin e kushteve, që të garantojnë arritjen e këtyre objektivave:

- a) të mbajnë në efikasitet ndarjet e objektit;
 - b) të evitojnë riciklimin e produkteve të djegshme ose gazrave të tjerë të rrezikshëm;
 - c) të mos shkaktojnë probleme avarie ose prishje të ajrit, si dhe të mos e përhapin atë në objektet ngjitur;
 - d) të mos krijojnë elemente përhapje të tymit ose të flakës në fazën e fillimit të zjarreve.
- Të tilla objektiva konsiderohen të drejta për impiantet si këshilla specifike.

8.2.2.1 Impiante qendrore

Pjesët në trajtim të hapësirave dhe të grupeve frigoriferike nuk mund të jenë instaluar në të njëjtat ndarje të objekteve ku janë instaluar impiante të prodhimit të nxehtësisë.

Grupet frigoriferike duhet të jenë instaluar në shtesa objektësh të ndërtuara në struktura të veçanta të karakteristikave me rezistencë ndaj zjarrit jo më të vogël se REI 60, me dalje të drejtëpërdrejtë nga jashtë ose nëpërmjet rrugëve të shkarkimit të zonave të daljes me karakteristika analoge të paktën, ku dyert e kanë rezistencën ndaj zjarrit REI 60 dhe të jenë të pajisura me sistem vethapës nga brenda.

Hapësirat në objekte ku janë instaluar grupet frigoriferike me sipërfaqet minimale që ato zënë, nuk duhet të jenë më pak se 1/20 e sipërfaqes të përgjithshme të objektit. Grupet frigogjene duhet të shfrytëzohen si lëngje rrjedhëse prodhime jo të të djegshme dhe johelmuese.

Grupet frigoriferike që prodhojnë solucione ujore të amoniakut, mund të jenë të instaluar vetëm jashtë objektit ose në objekte ngjitur me karakteristika analoge të centraleve termike të ushqyer me burime gazi.

Centralet frigoriferike të destinuar për mbajtje grupesh termofrigoriferike me thithje të nxehtësisë direkte, duhet të respektojnë dispozitat për parandalimin e zjarreve në fuqi, për impietet e prodhimit të nxehtësisë, referuar tipeve të djegshme në përdorim.

Nuk është pranuar shfrytëzimi i ajrit të ricikluar në kuzhinë, garazhe dhe çdo hapësirë me rrezik specifik.

8.2.2.2 Ujësjiellësi

Ujësjiellësi duhet të jetë realizuar me materiale të klasës 0 (zero) të reaksionit ndaj zjarrit. Tubacionet freksibël dhe rekordet duhet të jenë të klasës të reaksionit ndaj zjarrit jo më të madhe se klasi 2².

Ujësjiellësi nuk duhet të përshkojë:

- vende të pasigurta, që janë në qiell të hapur;
- hapësirat e shkallëve dhe hapësirat e përcaktuara për ashensorë;
- objekte që paraqesin rrezik për zjarr, shpërthime dhe plasje.

Ujësjiellësit duhet të përshkojnë struktura rezistente të zjarrit të klasës të paktën të barabartë me këto hapësira që përmenden më sipër.

Ujësjiellësit duhet të jenë mbyllur me materiale të rezistencës ndaj zjarrit të klasës 0, pa pengesa të tërë objektin dhe me zgjerim të njëjtë.

8.2.2.3 Sistemi i kontrollit

Çdo impiant duhet të jetë pajisur me sistemin e komandimit manual, situatë e një pike lehtësisht të kuptueshme, për ndalimin e ventilatorëve në rast rreziku.

Gjithashtu, impiantet që riciklojnë ajrin, në shërbim të më shumë pjesëve ndarëse të objektit të pajisur në brendësi të ujësjiellësit me tregues të tymit që komandon automatikisht ndalimin e ventilatorëve dhe mbyll (brezin kundër zjarrit). Ndërhyrja e treguesit duhet të jetë sinjalizuese në qendrën e kontrollit, siç përshkruhet në pikën 12.2.

Ndërhyrja në sistem, qoftë sistemi manual ose sistemi automatik, nuk duhet të pranojë rivënien e prishur të ventilatorëve në punë pa ndërhyrë manuali i operatorit.

8.2.2.4 Skemat funksionale

Për çdo impiant, duhet të jetë parapërgatitur një skemë funksionale, në të cilën shpjegohen:

- vendkalimet e strukturave rezistente ndaj zjarrit;
- vendndodhjet në brendësi të zjarrpenguesve (brezat kundër zjarrit);
- vendndodhja e ventilatorëve të tymit, si dhe komandat manuale (automatike);
- skemat e fluksit të ajrit parësore, si dhe sekondare;
- logjika momentale e manovrimit të veprimeve në rastet e emergjencave.

8.2.2.5 Impiantet lokale

Është pranuar si kushtëzim që ajri në gjysmë të kondicionimit, në kondensim gazi frigoriferik të mos jetë i ndezshëm. Ky është eskuzivisht detyrim, që aparaturat të ndërhyjnë në zjarr të lirë.

8.3 Garazhet

Garazhet në shërbim të veprimtarisë turistike duhet të jenë rerealizuar në përputhje me limitet e parandalimit të zjarreve, parashikuar sipas dispozitave në fuqi.

8.4 Hapësirat për mbledhje, argëtim, pritje dhe të ngjashme me to

Në objekte me të tilla hapësira, të frekuentuara nga publiku, të ftuarit ose jo në aktivitete akomoduese, hapur brenda caqeve të një objekti ose kompleksi turistik të destinuar për dëfrim, argëtim pritje apo mbledhje, aplikohen normat pasuese për parandalimin e zjarreve. Titulli i ilustruar më sipër sipas situatës mund të përfshijë:

- konferenca,
- takime,
- sfilata mode,
- mbledhje gostie,
- pak spektatorë për kabare,
- festa vallëzimi,
- ekspozita arti, merceologjie etj.

8.4.1 Vendndodhja

Objektet (lokalet) e dëfrimit mund të ndodhen pothuajse në kuotat e mbikatis të nivelit të rrugës dhe të kateve të poshtme, jo më ulët se thellësia -10 metër nga kati i rrugës.

8.4.2 Komunikimi

Objektet (lokalet) e dëfrimit me kapacitet më të vogël se 100 persona mund të komunikojnë direkt me ambientet që ushtrojnë aktivitet akomodues turistik, sipas normave me tregues të zonave me rrezik specifik.

Për objektet e tjera të treguara në komunikim me ambiente të tjera të aktivitetit turistik, duhet të jenë vendosur nëpërmjet dyerve me rezistencë ndaj zjarrit REI 30. Sepse një situatë e tillë nuk bie në kundërshtim me normat për parandalimin e zjarreve relative, në zonat me rrezik specifik.

8.4.3 Strukturat e materialeve

Në lidhje me kushtet e rezistencës ndaj zjarrit të elementëve strukturorë dhe të karakteristikave të reaksionit ndaj zjarrit të materialeve të përdorura, si dhe mobiljeve, duhet të përputhen me përshkrimet e përcaktimeve të pikave 6.1, 6.2.

8.4.4 Përmasat për evakuim në raste emergjencash

Grumbullimet maksimale të hipotëzuara në këto objekte, në të cilën publiku gjendet në vende të tilla i pranishëm, ose i ulur dhe i shpërndarë në grupe e sektorë, vjen e fiksuar së pari nga numri i vendeve të karrikeve.

Në raste të tjera vjen e fiksuar barabartë kur rezultati i ulët dhe përqendrimi i grumbullimit nuk është më i madh se 0,7 persona për m² dhe në çdo rast duhet të jëtë deklaruar nën përgjegjësinë direkte të titullarit të aktivitetit. Objektet duhet të jenë vendosur në një sistem organizimi të rrugëve të eksodit për personat sipas rregullave në fuqi dhe këtyre përshkrimevetë mëposhtme:

a) Objekte me kapacitet mbi 100 persona: duhet të jenë plotësuar kriteret për të dalë, që për numër e dimension janë konform normave në fuqi mbi këto objekte për spektakle dhe aktivitete ngjashme me to; të paktën gjysma e daljes duhet të tregojë direkt së jashtmi vendin e qetë, të sigurt e dinamik; ndërsa të tjerët mund të futen në sistemin e rrugëve të daljes së evakuimit të katit.

b) Objekte me kapacitet të përgjithshëm midis 50 dhe 100 persona: duhet të jenë të pajisur të paktën me dy dalje, me thellësi konform normave në fuqi për parandalimin e zjarreve, për objektet në përdorim të publikut për spektakle, që futen në sistemin e rrugëve të evakuimit të daljeve në kat.

c) Objektet me kapacitet më të vogël se 50 persona: është e lejuar që këto objekte të jenë në shërbim me një dalje të vetme për evakuim, gjerësia e daljeve nuk duhet të jetë më e vogël se 0,90 m, gjerësi që përfshihet në sistemin e rrugëve të daljes në kat.

8.4.5 Vendosja e vendeve për t'u ulur

Vendosja e vendeve për t'u ulur duhet të jetë konform normave në fuqi, me përjashtim të objekteve të destinuara për kërcime festive, mbledhje të përbashkëta etj., për të cilat është e këshillueshme që karriket të mos jenë të bashkuara midis tyre dhe në situata të tjera të jenë të ndara sipas nevojave të rastit, me kusht që të mos përbëjnë pengesë për daljen e personave në raste emergjence dhe evakuimi.

9. IMPIANTET ELEKTRIKE

Impianti elektrik duhet të jetë realizuar konform akteve ligjore dhe normave të sigurisë teknike në fuqi.

Në veçanti, për parandalimin e zjarreve, impiantet elektrike:

- nuk duhet të krijojnë premisë për zjarr dhe shpërthim;
- nuk duhet të krijojnë burime ose rrugë ushqimi, që favorizojnë shpërndarjen e zjarrit; ndarjet (e mbulesës) e zjarrit duhet të jenë ndarë me destinacion specifik të përcaktuar përdorimi të objektit;

- mund të jenë të mbindarë, në mënyrë të tillë që një prishje e mundshme e impiantit të mos provokojë nxjerrjen e impiantit jashtë shërbimi në të gjithë sistemin;

- të jenë vendosur e pajisur me aparatura të manovrueshme të vendosura në pozicion “mbrojtjeje”, ku duhet të vendosen qartë treguesit e qarqeve që i përkasin (këto të fundit të shënuara).

Rregullat e mëposhtme duhet të shoqërojnë impiantet e sigurimit:

- a) ndriçimi;
- b) alarmi;
- c) zbulim, tregim të papritur;
- d) impiantet e fikjes së zjarreve;
- e) pajisjet kundër zjarrit.

Ushqimi i siguresave duhet të jetë me shkëputje automatike të shkurtra, më të vogla ose të barabarta me 0,5 sekonda për impiantet e shpërndarjes, alarmit, ndriçimit dhe ndërprerja mesatare më e vogël dhe e barabartë se 15 sekonda për pajisjet antizjarr dhe impiantet hidrike antizjarr.

Mekanizmi i karikimit të baterive (akumulatorëve) duhet të jetë i tipit automatik, i tillë që të shpërndajë karikimin komplet brenda 12 orësh.

Pavarësia e ushqimit të siguresave duhet të përmbajë përmbushjen e sigurt të ndihmës së shpejtë dhe të fikjes në kohën e nevojshme.

Për çdo rast, pavarësia minimale vjen e stabilizuar për çdo impiant si më poshtë:

- lajmërimi, zbulimi, diktimi, alarmi: 30 minuta;
- ndriçimi i sigurimit: 1 orë;
- pajisjet antizjarr: 1 orë;
- impiantet hidrike antizjarr: 1 orë.

Instalimet e grupeve elektrogjene duhet të jenë sipas normave teknike të përcaktuara në fuqi.

Impiantet e ndriçimit të sigurimit duhet të sigurojnë një nivel ndriçimi jo më të vogël se 5 luks në një metër lartësi, nga kati i shkelur në rrugët e daljes.

Vendosen llampa teke me ushqim të pavarur, por që sigurojnë ndriçim me funksionimin të paktën një orë.

Kuadri elektrik i përgjithshëm duhet të jetë vendosur në pozicion të dukshëm, lehtësisht të përdorshëm, sinjalizuar me tregues dhe i mbrojtur nga zjarri.

9.1 Rrufepritësit:

a) Për të evituar rrezikun e zjarrit që mund të vijë nga shkarkimet atmosferike, objektet e klasifikuara në dispozitën 1 të këtij vendimi, detyrimisht, duhet të pajisen me sistemin mbrojtës për shkarkimet atmosferike.

b) Ndërtohet mbi bazë të një studimi, i cili është pjesë e projektit teknik që shoqëron dokumentacionin e objektit.

c) Këtij sistemi i bëhet kontrolli çdo 6 muaj për gjendjen teknike, ku të dhënat pasqyrohen në regjistrin e kontroleve, përcaktuar sipas përshkrimeve të pikës 16 të kësaj rregulloreje.

10. SISTEMI I ALARMIT

Objektet apo pjesë të tilla të destinuara për aktivitetet akomoduese pritëse, duhet të jenë të mbrojtura nga një sistem alarmi akustik, në gjëndje të paralajmërojë të ftuarit dhe personelin present në kushtet e rrezikut të rënies së zjarrit.

Pajisjet zanore duhet të kenë karakteristika dhe vendosje të tillë, që të mund të sinjalizojë rrezikun për të gjithë punonjësit të pranishëm, ose pjesëve që përfshihen nga zjarri.

Komandimi i funksioneve të njëkohshëm i të gjitha pajisjeve zanore duhet të jetë vendosur në një ambient mbizotërues, nën kontrollin e vazhdueshëm të personelit përkatës, mund të jetë parashikuar një komandë e dytë e centralizuar e vendosur në një ambient që nuk ka rreziqe të veçanta zjarri.

Për ndarjet e impianteve fikëse të diktimit dhe sinjalizimit të zjarrit, sistemi i alarmit duhet të funksionojë automatikisht, si në rastin e përshkruar në pikën 12 të rregullores.

Funksionimi i sistemit të alarmit duhet të jetë i garantuar edhe në rastin mungesës së ushqimit elektrik kryesor, për një kohë jo më të vogël se 30 minuta.

11. MJETET DHE IMPIANTET E FIKJES SË ZJARRIT

11.1 Të përgjithshme

Aparaturat e impianteve të fikjes së zjarrit duhet të jenë realizuar sipas normativave standarde të miratuara, si dhe normave ndërkombëtare të konformitetit në fuqi.

11.2 Fikësit e zjarrit

Gjithë aktiviteti akomodues turistik duhet të jetë pajisur, në mënyrë të tillë dhe në përputhje me numrin e fikseve të lëvizshme.

Fikësit e zjarrit duhet të jenë të harmonizuar dhe të certifikuar konform kriterëve të përcaktuar në një nga vendet e Komunitetit Europian.

Fikësit e zjarrit duhet të jenë shpërndarë në mënyrë uniforme në hapësirë për mbrojtje, ku sidoqoftë të paktën njëri nga fikësit duhet të gjendet:

- përbri pajisjeve që mund të shërbejnë si ndezës zjarri;
- afër zonave me potencial rreziku zjarri.

Fikësit e zjarrit duhet të ndodhen në pozicione lehtësisht të arritshëm dhe të kapshëm, si dhe të shikueshëm nga të pranishmit.

Mbishkrimi i udhëzuesit tregues në fikësin e zjarrit duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm në distancë. Fikësit portativë duhet të jenë instaluar në propocion të çdo 200 metrave katror të dyshemesë, ose pjesë fraksioni me një minimum një fikës për çdo kat.

Fikësit e zjarrit portativë duhet të kenë kapacitet shuarje jo më të vogël se 13A-89B.

Për mbrojtjen e hapësirave dhe impianteve me rrezik specifik, duhet të jenë parashikuar fikës zjarri të tipit të përshtatshëm.

Për aktivitetet akomoduese deri në 25 shtretër është i mjaftueshëm instalimi i një fikësi zjarri të vetëm.

11.3 Impiante hidrike antizjarr

Hidrantët hidrikë duhet të jenë përgjithësisht të pajisur:

- shpërndarë në mënyrë të pranuar për të ndërhyrë në të gjitha hapësirat e aktivitetit akomodues;

- vendosur në çdo kat në hapësirat me shumë kate;
- dislokuar në pozicione lehtësisht të arritshme e të kapshme;
- mbishkrimi i udhëzimit tregues të jetë i lexueshëm me lehtësi në distancë.

Hidrantët nuk duhet të jenë vendosur në vende brenda shkallëve, në mënyrë që të mos pengojë eksodin e personave. Prezenca e shkallëve të brendshme të tipit të provës së tymit të mund të lejojë lehtësisht operacionin e ndërhyrjes së strukturave të zjarrfikësve. Hidrantët duhet të ndodhen brenda filtrit të provës së tymit.

11.3.1 HIDRANT DN 20

Aktivitetet me numër shtretërish mbi 25 dhe nën 100 duhet të jenë të paktën të pajisur me hidrantë DN 20.

Çdo hidrant duhet të jetë pajisur me një tubacion të gjatë 20 m, realizuar sipas rregullave dhe normave në fuqi. Hidrantët duhet të jenë lidhur me një rrjet hidrik normal, sepse kështu mund të mbahen në çdo moment në të njëjtën kohë në përdorim normal. Dy hidrantë në pozicione hidraulike të kundërta, duhet të sigurojnë në çdo dalje prurje jo më të vogël se 35 l/min, me një presion jo më të vogël se 1.5 bar, kur kemi hyrë në fazën e shkarkimit.

Çdonjëri prej tyre duhet të sigurojë një pavarësi jo më të vogël se 60 minuta. Kur rrjeti hidrik nuk siguron përshkrimet e mësipërme, duhet përdorur ushqim rezervë, me kapacitet të njëjtë aftësie dhe të furnizojë të njëjtin presion.

11.3.2 Hidrantë DN 45

Aktivitetet me kapacitet mbi 100 shtretër duhet të jenë pajisur me hidrantë DN 45. Çdo hidrantë duhet të jetë pajisur me një tub fleksibel të gjatë 20 m.

11.3.2.1 Rrjeti i tubacionit

Impianti hidrik antizjarr duhet të jetë krijuar nga një rrjet tubacioni, realizuar (preferohet unazë rreth) për montimin, për vendosjen në shkallë.

Për çdo montim që i korrespondon çdo kati, duhet të jetë derivat i tubacioneve me diametër të brendshëm, jo më të vogël se 40 mm, një pengesë për hidrantët DN 45.

Rrjeti i tubacionit të hidrantit duhet të jetë i pavarur nga rrjeti hidrik për shërbim sanitar.

Tubacionet duhet të jenë të mbrojtura nga ngrirja, nga zënia e skorrjeve metalike, ndaj zjarrit.

11.3.2.2 Karakteristikat hidraulike

Hidranti duhet të ketë karakteristika hidraulike që të garantojë një prurje prej 360 l/min për çdo "shtyllë" të montuar.

Rrjeti duhet të jetë në gjendje të garantojë të paktën që 3 hidrantë në pozicion hidraulik më të favorshëm, të sigurojnë që çdonjëra nga prurjet të mos jetë më pak se 120 l/min, me një presion dalje uji prej 2 bar.

Tubacioni hidrik duhet të paktën të sigurojë autonominë prej 60 minutash.

11.3.2.3 Prurja

Impianti duhet të ketë prurje normale furnizimi nga ujësjellësi publik. Kur ky ujësjellës nuk garanton kushtet dhe kondicionet e parashikuara më lart, duhet të realizohet një rezervë hidrike me të njëjtin kapacitet.

Grupi i pompimit të prurjeve të rrjetit antizjarr duhet të jetë realizuar nga elektropompa me ushqim elektrik me rezervë (grup etrogjen ndërhyrës automatik), nga një motorpompë me ndezje automatike.

11.3.2.4 Prurje me shumë besueshmëri

Për aktivitetet akomoduese me më shumë se 500 shtretër dhe për këtë vendosje të objekteve me lartësi antizjarr më të mëdha se 32 m, prurja e rrjetit antizjarr duhet të jetë e tipit me shumë besueshmëri.

Që prurja të konsiderohet me shumë besueshmëri duhet të jetë realizuar me një nga mënyrat e mëposhtme:

- një rezervë potenciale e pashtershme;
- dy sebratorë ose vaska për akumulim, me kapacitet të veçantë të minimumit që kërkon impianti pajisur me rezervë;
- dy “këputje” ujësjellësi që nuk interferojnë ndërmjet tyre, pra nuk janë prurje të të njëjtit burim, realizuar me mundësi potenciale të pashtershme;

Këto prurje duhet të jenë lidhur në një rrjet antizjarr ndërmjet tyre, me dy grupe pompash të përbëra nga një ose më shumë pompa. Çdonjëra nga këto pompa është në gjendje të sigurojë prezencën e kërkuar sipas këtyre kërkesave:

- një elektropompë dhe një motorpompë, njëra rezervë e tjetrës;
- dy elektropompa, çdonjëra çon barabartë me gjysmën e nevojës dhe një tjetër motorpompë rezervë, me fuqi ngjitjeje të barabartë me nevojën e përgjithshme;
- dy motorpompa, njëra rezervë e tjetrës;
- dy elektropompa, njëra rezervë e tjetrës, me prurje elektrike të pavarur.

Çdonjëra nga pompat duhet të punojë automatikisht.

11.3.3 Hidranti DN 70

Në strukturat me veprimtari akomoduese me mbi 500 shtretër të këtyre vendndodhjeve të objekteve me lartësi antizjarr mbi 32 m, duhet asistuar nga jashtë në pozicionin më të arritshëm, në kohën e duhur të sinjalizimit, të paktën një hidrant DN 70 i dobishëm për ndërhyrjen e strukturave të zjarrfikësve.

Këto hidrante duhet të sigurojnë të paktën një prurje jo më të vogël se 460 l/min për të paktën 60 minuta.

Në rastet e të njëjtit rrjet ushqimi, ku hidrantët e brendshëm janë të njëjtë me ato të jashtëm, prurja e ushqimit duhet të sigurohet të paktën si nevojë me përshtatje, si dhe me përdorim kompleks.

11.3.4 Lidhja me autopompën e automjetit zjarrfikës.

Në këmbët e kolonave në hyrje të objektit me më shumë se tre kate mbi tokë, montohet dhe duhet të jetë instaluar një autopompë e tipit të përmasave që përdorin automjetet e shërbimit zjarrfikës.

11.3.5 Impianti i fikjes automatike

Një tjetër rrjet hidranti montohet në strukturat akomoduese turistike deri në 1000 shtretër, ku duhet të jetë present impianti i fikjes automatike me shi (formë dushimi) në të gjithë sipërfaqen e aktivitetit akomodues turistik.

12. IMPIANTI I ZBULIMIT (DIKTIMIT) DHE I SINJALIZIMIT TË ZJARREVE

12.1 Të përgjithshme

Në aktivitetet akomoduese turistike me kapacitet 100 shtretër duhet të jetë parashikuar instalimi i një impianti i cili bën të mundur të zbulojë e të diktojë dhe të sinjalizojë automatikisht praninë e zjarreve. Me aftësi të zbulojë e sinjalizojë në distancë dhe që në fillësë një rrezik, që sapo ka ndodhur në ambientet e aktivitetit.

Në ambientet e depozitave magazinë në mënyrë të pavarur nga numri i shtretërve, duhet të instalohet në çdo një prej tyre, impiante siç parashikohet në pikën 8.1 të kësaj rregulloreje.

12.2 Karakteristikat

Impiantet duhet të jenë të mbrojtur sipas dispozitave dhe rregulloreve në fuqi.

Sinjalizimi i alarmit duhet të vijë si rezultat i zbulimit, diktimit i cili duhet të jetë gjithmonë një sinjalizim pamor (optik) dhe zanor (akustik) i alarmit antizjarr në centralin e komandimit e të kontrollit të sinjalizimit, ku ai duhet të jetë vendosur në një vend të dukshëm.

Impianti i sipërcituar duhet të pranojë e të lejojë vënien në lëvizje automatikisht të alarmit në vende, në këto aktivitete:

a) 2 minuta të lëshojë sinjal alarmi si rezultat i dy a më tepër zbuluesish, ose të lëshojë pulsime të njëtrajtëshme sinjali antizjarr;

b) 5 minuta të lëshojë një sinjal alarmi si rezultat i zbuluesve ose sinjalizuesve, në qendrën e alarmit (central qendror), që nuk duhet të preket nga personat e pranishëm.

Kohët e sipërcituara mund të modifikohen në konsideratë me tipologjinë e aktivitetit dhe të riskut dhe të numrit të fiksëve të zjarrit.

Kur janë parashikuar rregullat teknike të pranishme, ose mbrojtje të aktivitetit akomodues, impianti i zbulimit duhet të pranojë automatikisht aktivizimin nga një apo më shumë ndikime, në mënyrë të tillë që:

- mbyllja automatike e pengesave eventuale të zjarrit, normalisht të hapura të pjesëve të tyre antizjarr, në çdo rast të tillë duhet të vijë sinjalizimi në rrugët e kalimit të aktivitetit sipas normave për mbylljen;

- çaktivizimi elektrik i mundshëm i impiantit të ventilatorit ose kondicionerit ekziston;

- aktivizimi i mundshëm i filtrave në mbi presion;

- mbyllja e mundshme e “pengesave” për ndalim zjarri, ekzistojnë vende në kanalizimet e impianteve të ventilimit ose kondicionimit, duke iu referuar ndarjeve nga vjen sinjalizimi;

- mundësia e transferimit në distancë të sinjalizimit të alarmit në vende të dukshme, në një kat operativ të brendshëm të emergjencës;

Në aktivitetet akomoduese me më pak se 300 shtretër ose më shumë se 100 shtretër, vendndodhja në brendësi e ndarjeve në lartësinë mbi 24 m duhet të jetë instaluar sistem optik, që përsërit alarmin në gjatësinë e gjithë korridorit për zbuluesit në vendndodhje në kamera, si dhe për ruajtje.

Çdonjëri nga zbuluesit duhet të jetë parashikuar për të zbuluar dhe treguar hapësirën (zonën), që nuk shihet direkt në mënyrë vizive.

13. SINJALISTIKA E SIGURISË

Sinjalistika e sigurisë duhet të jetë konform akteve dhe normave teknike në fuqi. Pozicioni dhe funksioni i hapësirave të qeta duhet të jetë kategorikisht e sinjalizueshme.

14. ADMINISTRIMI I SIGURISË

14.1 Të përgjithshme

Përgjegjësit e aktivitetit kujdesen që rruga e drejtimit nuk vjen në kundërshtim me kushtet e sigurisë dhe në veçanti me:

- në sistemin e rrugëve të daljes nuk janë lidhur pengesa (depozita, mobilje etj.) që vështirësojnë evakuimin e personave, e cila kthen largësinë që përbën rrezik për paraqitjen e zjarreve;

- mbahen në efikasitet mjetet në impiantet antizjarr, si dhe janë realizuar në kohën e duhur të mundshme mirëmbajtja e nevojshme e ujësjellësve në mënyrë periodike, me rritëm çdo 6 muaj;

- janë rrethana të mundshme të sigurisë në raste të situatave të veçanta, si për shembull: mirëmbajtja, risistemimi etj.;

- janë mbajtës të konstatimit në efikasitet impiantet e ventilimit, kondesimit, të ngrohjes; në rast kontrolli duhet të jetë sinjalizuar siguria antizjarr dhe duhet të jetë parashikuar një provë rreziku e njëjtë me skadimin, jo më larg se 1 vit; centralet termike duhet të jenë të besueshme dhe të certifikuara kualifikisht, të konfirmuara dhe homologuara në bazë të akteve ligjore në fuqi dhe të rregullave teknike ndërkombëtare;

- janë mbajtës konstatimi në efikasitet, impiantet elektrike në konformitet, siç është parashikuar në dispozitat në fuqi.

14.2 Thirrja e shërbimit të ndihmës

Shërbimi i ndihmës duhet të jetë lajmërim i thjeshtë, me rrjet telefonik. Procedura e lajmërimit duhet të jetë direkte, nëpërmjet aparatit telefonik kur është e mundshme. Në rast të rrjetit telefonik publik, numri i lajmërimit të zjarrfikësve duhet të jetë i vendosur mirë që të shihet qartë në aparaturën e telefonit të shërbimit.

15. STËRVITJE MËSIMORE E PERSONELIT

15.1 Ndëryrja e parë dhe vënia në lëvizje të sistemit të alarmit

Përgjegjësi i aktivitetit duhet të pranojë me qëllim që, në rastet e zjarreve, personeli të jetë në gjendje të kryejë në mënyrë korrekte me pajisjet të disponueshme operacionin për ndërhyrjen e parë, për më tepër të vëjë në lëvizje sistemin e alarmit dhe sistemin e thirrjes së ndihmës.

Këto operacione duhet të jenë të qarta dhe tregues të personave të ngarkuar në formë të shkruar.

Personeli i aktivitetit, të paktën 2 herë në vit, duhet të thërritet në mbledhje për përdorim të instruksioneve të alarmit dhe të thirrjes së ndihmës, për më tepër për ushtrimin e evakuimit për lëvizjen në kate dhe në emergjenca të mundshme të parashikuara.

15.2 Plani i lëvizjes (zbatimi)

Në rastet e zjarreve, personeli i aktivitetit akomodues duhet të jetë detyruar të zbatojë udhëzimet e lëvizjes dhe konkretisht:

- aplikimin e instruksioneve që janë shkruar mbi pajisjet;
- kontribuim të efektshëm për evakuimin të gjithë të pranishmëve në aktivitetin turistik.

15.3 Aktiviteti me kapacitet mbi 500 shtretër

Në aktivitetet akomoduese me kapacitet mbi 500 shtretër duhet të jetë parashikuar një shërbim sigurimi i nevojshëm i mirëorganizuar në përbërje të një përgjegjësie të ngarkuar për stërvitjen. Për të qenë gati për ndërhyrje dhe të jetë pajisur me ekip të përshtatshëm dhe të kualifikuar.

16. REGJISTRI I KONTROLLEVE

Duhet të jetë parashikuar një regjistër i kontrolleve periodike në dispozicion të veprimtarisë akomoduese, ku shënohen të gjitha ndërhyrjet, kontrollet realisht dhe efektivisht të impianteve elektrike, ndriçimit, sinjalizimit, sigurisë dhe të antizjarrit.

Në këto regjistra shënohen dispozitat e sigurisë, të kontrollit në zonat me rrezik specifik, të vëzhgimit të kufijve të karikimeve antizjarr në këto ambiente të aktivitetit, për më tepër mbledhja e stërvitjes dhe ushtrimit të evakuimit.

Këto regjistra duhet të jenë gjithmonë të konstatuara me kontrolle të dispozitave për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, nga ana e strukturave të shërbimit zjarrfikës.

17. INSTRUKSIONI I SIGURISË

17.1 Instruksioni i paraqitur në hyrje

Në hyrje të veprimtarisë akomoduese duhet të jenë ekspozuar dukshëm në pamje, pjesë instruktuese relative të objektit për personelin dhe publikun, në mënyrë të shkurtuar e të thjeshtë, si dhe planimetria e objektit. Gjithashtu, për skuadrat e shpëtimit, këto instruksione duhet të tregojnë pozicionet:

- të shkallëve dhe rrugëve të evakuimit;
- të pjesëve të impianteve fikëse disponibël;
- të rregullave të ndalimit të impianteve të depozitave të gazit, si dhe të impiantit elektrik;
- rregullave të ndalimit të sistemit të ventilimit;
- të kabinës qendrore të sistemit të zbulimit (diktimit) dhe të alarmit;
- impiantet e pjesëve të objektit me rrezik specifik;
- të hapësirës së qetë.

17.2 Instruksioni i paraqitur në çdo kat

Në çdo kat duhet të jetë i paraqitur planimetria e orientimit të rrugëve për evakuim.

Pozicioni dhe funksionimi i hapësirës së qetë duhet të jetë qartësisht e sinjalizuar.

17.3 Instruksioni i paraqitur në çdo dhomë

Në çdonjërin nga dhomat në mënyrë preçize vendoset instruksioni i paraqitur në mënyrë të qartë dhe duhet të tregojë pjesët që janë potencialisht raste për zjarr.

Instrukcionet duhet të jenë të shkruara në disa gjuhë, ku dominon gjuha e klientelës që frekuenton veprimtarinë akomoduese.

Këto instruksione duhet të jenë shoqëruar nga një planimetri e thjeshtëzuar e katit, ku tregohet skematikisht pozicioni i dhomës respektive, rrugët e evakuimit, të shkallëve dhe të daljeve.

Instrukcionet gjithashtu duhet të tërheqin vëmendjen për të ndaluar përdorimin e ashensorin në rast zjarri.

Gjithashtu instrukcionet duhet të tregojnë ndalim:

- të zënies të vatrave të ndonjë lloj pajisjeje për ngrohje e gatim, stufat dhe aparatet të nxehtësisë ose të ndriçimit, në përgjithësi të funksionimit elektrik me rezistencë në pamje, ose pajisjeje me mbushje të lëndëve të djegshme të gasta.

- të mbajtjes së depozitave në mënyrë modeste, substancave të djegshme në objekte, të cilat janë pjesë e punës së volumit të destinuar për aktivitetin.

PJESA E DYTË AKTIVITETE AKOMODUESE NË OBJEKTE EKZISTUESE

18. VENDNDODHJA

Vendodhja e aktiviteteve akomoduese ekzistuese duhet të respektojë përcaktimet në pikat 5.1 dhe 5.2, realizuar sipas përshkrimeve të pikës 20.5.

5. VENDNDODHJA

5.1. Të përgjithshme

Ndërtesat e destinuar për aktivitetet akomoduese turistike vendosen në mënyrë të tillë, ku respektohen distancat e sigurisë, të përcaktuara nga dispozitat në fuqi, distancat që kërkohen nga aktivitetet e tjera, që sjellin rreziqe shpërthimesh nga zjarret. Aktivitetet akomoduese mund të jenë vendosur:

c) në ndërtesa të ndara e të ndërtuara, për një specifikë të tillë të parashikuar në rregullore dhe të izoluar nga të tjerat.

d) Në ndërtesa ose objekte që janë në vazhdim, ose ndërtesa të tjera me destinacione të ndryshme, por duke pasur parasysh normativat specifike, këto destinacione i nënshtrohen kontrolleve të strukturave të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin, siç përcaktohet në dispozitat në fuqi.

5.2 Ndarjet, komunikimi

Duke marrë në konsideratë sa është përcaktuar në rregullat teknike, aktivitetet akomoduese turistike:

e) nuk mund të komunikojnë me aktivitetet që nuk i përkasin atyre.

f) mund të komunikojnë direkt me aktivitetet që u përkasin atyre, por që nuk janë subjekt i kontrolleve të PMNZSH-së.

g) mund të komunikojnë nëpërmjet filtrave të provës të tymit ose hapësirave të zbuluara me aktivitetet e lejuara, subjekt i kontrolleve të strukturave të PMNZSH-së.

h) duhet të jenë të ndara nga aktivitetet e treguara në germën “a” dhe “c” të kësaj pike, nëpërmjet strukturave të karakteristikave të paktën me rezistencë të pjesëve të brendshme të ndarjeve ndaj zjarrit 90 minuta (REI 90).

19. KARAKTERISTIKAT KONSTRUKTIVE

19.1 Rezistenca e zjarrit e strukturave

Kërkesat e rezistencës ndaj zjarrit të elementeve të objektit vlerësohen siç është parashikuar në përcaktimet e pikës 6.1, me aplikim të vlerës minimale sipas tabelës:

Lartësia antizjarr e ndërtesës (m)	Rezistenca e objektit ndaj zjarrit (R)	Rezistenca e pjesëve të brendshme të objektit (REI)
Deri në 12 m	30	30
Mbi 12 m deri në 54 m	60	60
Mbi 54 m	90	90

Në alternativë është pranuar që elementët strukturalë mbajtës dhe të ndarë të garantojnë një rezistencë ndaj zjarrit R/REI sipas përcaktimeve të tabelës së mëposhtme:

Lartësia antizjarr e ndërtesës në (m)	R/REI (*)	R/REI (**)
Deri në 24 m	45	30
Mbi 24 m deri në 54 m		45
Mbi 54 m		60

(*) prezenca e impiantit të zbulimit dhe të sinjalizimit të zjarreve është e përhapur në brendësi në aktivitetin akomodues turistik.

(**) prezenca e impiantit të zbulimit dhe sinjalizimit antizjarr e shtrirë në brendësi të aktivitetit dhe një shërbim i brendshëm sigurimi permanent i pranishëm në harkun e njëzet e katër orëve.

6.1 Rezistenca ndaj zjarrit e strukturave

Kërkesat e rezistencës ndaj zjarrit të elementeve strukturale, duhet të vlerësohen në bazë të përshkrimeve dhe modaliteteve të provës, të vendosura nga dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore, në varësi të tipit të materialit të përdorur, në realizimin e elementëve të ndërmjetëm (beton, çelik, dru masiv, dru i laminuar, elementë përbërës, etj.).

Elementet strukturore duhet të jenë njohur ligjërisht në një nga vendet e Komunitetit European, në bazë të normave të harmonizimit ose të normave dhe rregullave teknike të huaja të njohura, ekuivalente nga vende kontraktuese të markave CEE, të cilat mund të tregtohen në vendin tonë. Për këtë qëllim përdoruesi për secilin prototip duhet të paraqesë kur i kërkohen nga instancat përkatëse certifikatat e cilësisë, duke i motivuar aprovimin ose mosaprovimin e materialeve.

Kjo instancë që bën fjalë paragrafi i mësipërm duhet të ketë dokumentacionin e nevojshëm, për indentifikimin e produktit, certifikatave relative të provës, të lëshuara ose të rinjohura nga organet kompetente të shtetit unitar të Komunitetit European.

Dimensioni i spesorëve dhe i mbrojtjeve, për t'u adaptuar për tipe të ndryshme materialesh, si dhe klasifikimi i ndërtesave në funksion të ngarkesave të zjarrit, përcaktohen nga përlllogaritja e ngarkesave për zjarr, për objekte që kanë struktura mbrojtëse prej druri. Kërkesat e rezistencës ndaj zjarrit të dyerve dhe elementeve të tjerë mbyllëse vlerësohen dhe certifikohen në bazë të dispozitave të të parashikuara në akte nënligjore.

Strukturat mbrojtëse duhet të garantojnë rezistencën ndaj zjarrit (R) dhe strukturave ndarëse në to, (REI) rezistenca e pjesëve të brendshme të objektit ndaj zjarrit) në bazë të tabelës së mëposhtme:

Lartësia antizjarr	R	REI
Deri 24 m	60	60
MBI 24 m deri në 54 m	90	90
Mbi 54 m	120	120

Për strukturat në lidhje me zonat me rrezik specifik të shtuar, duhet të aplikohen dispozitat e vendosura në normativa nënligjore respektive.

19.2 Reaksioni i zjarrit ndaj materialeve

Kërkohet respektimi i përcaktimeve të pikës 6.2 të kësaj rregulloreje me përjashtim të pikës “e”, realisht mobiljet dhe materialet prej cope jorgan, dyshek, kolltuk etj.

6.2 Reaksioni i zjarrit ndaj materialeve

Materialet e instaluar në strukturat akomoduese turistike duhet të kenë koficientët specifike, si më poshtë:

a) në ambiente, në korridore, në shkallë, në sheshpushime shkallësh, në kalimet në përgjithësi, lejohet përdorimi i materialeve të klasës 1, në masën 50% të maksimumit të sipërfaqes të tyre totale (dyshe + tavanë + parete + projektimi horizontal i shkallëve), kurse për pjesën e mbetur duhet të përdoren materiale të klasës 0, jo të djegshme.

b) në të gjitha ambientet e tjera lejohet që dyshemet duke përfshirë dhe riveshjet e tyre të jenë të klasit 2 dhe të gjithë materialet e tjera të riveshjes të jenë të klasit 1 ose dhe të klasit 2, nëse ka impiante të shuarjes automatike, ose të sistemeve të filtrimit të tymrave, të asistuar nga sisteme të zbulimit të zjarreve.

c) materialet e riveshjes së djegshme, si dhe materialet izoluese, për të cilat bën fjalë germa “f” e mëposhtme, të shpërndara nëpër klasa të ndryshme të reaksionit të zjarrit duhet të përdoren si elemente konstruktive të klasit 0, duke përjashtuar hapësirat boshe; duke marrë parasysh kufizimet e përshkruara në germën “a” lejohet instalimi, si dhe i materialeve të riveshjes dhe materialeve izoluese, në pamje të vendosura, të cilat kanë klasë të reaksionit ndaj zjarrit 1 ose 1-1 dhe janë të homologuara duke pasur parasysh kushtet efektive të përdorimit në lidhje me burimet e mundshme të lindjes së harkut elektrik.

d) materiale të predispozuar të marrjes zjarr në të dyja anët, si: (tenda, etj.) duhet të jenë të klasit të reaksionit ndaj zjarrit, më të madhe se 1;

e) mobiljet dhe dyshekët duhet të jenë të klasit 1 IM;

f) materialet izoluese në pamje, që duken direkt dhe ekspozohen ndaj flakëve duhet të jenë të klasit të reaksionit ndaj zjarrit jo më të madhe se 1; në rastin e materialeve izoluese në pamje me komponentë izolues jo të ekspozuar direkt ndaj flakëve lejohen klasat e reaksionit ndaj zjarrit 0-1; 1-0; 1-1.

Materialet që bëjnë fjalë në gerrat e mësipërme duhet të jenë të homologuara në bazë të dispozitave në fuqi.

Lejohet vendosja në punë e riveshjes prej druri, trajtuar në mënyrë opurtune me prodhime të vernikuara, të homologuara të klasës 1 të reaksionit ndaj zjarrit. Materialet izoluese të instaluar në brendësi të ndarjeve duhet të jenë jo të djegshme. Lejohet instalimi i materialeve izoluese jo të djegshme në brendësi të ndarjeve të realizuara nga struktura, të realizuara me materiale të padjegshme, që kanë rezistencë ndaj zjarrit të paktën REI 30.

19.3 Ndarjet

Ndërtesat duhet të jenë nëndarje të ndarjeve (të ndërtuara në masën e dy kateve) siç është parashikuar në pikën 6.3 të kësaj rregulloreje.

6.3 Ndarjet

Ndërtesat duhet të jenë të ndara me nëndarje, sipërfaqja e të cilave nuk duhet t'i kalojë përmasat e tabelës A.

Pranohet se dy kate mbi tokë të ndërtesave përbëjnë një pjesë të vetme të ndërtimit, dhe sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit nuk duhet të jetë më e madhe se 4000 m². Kati i parë nëntokë, hapësirë e destinuar për të gjithë në shërbim të publikut, me kusht që kjo sipërfaqe nuk duhet të tejkalojë përmasat 1000 m².

Tabela A

Lartësia antizjarr	Sipërf. Mak e ndarjeve
Nën 24 m	3000 m ²
Mbi 24 m dhe nën 54 m	2000 m ²
Mbi 54 m	1000 (*) m ²

(*) ndarjet lejohen për tu zgjeruar vetëm në një kat.

Janë lejuar ndarjet në një sipërfaqe të përgjithshme jo më të madhe se 4000 m², në objekte me shumë kate në kushtet e ngarkesës antizjarr në çdo kat, jo mbi vlerën 30 kg/m², si dhe ku është instaluar një impiant automatik diktimi dhe alarmi antizjarr në të gjithë ambientin e objektit.

Është lejuar që ndarjet që kanë një sipërfaqe mbi 4000 m² dhe nën 8000 m² me kondicione të mëtejshme, si dhe të jetë instaluar në to një impiant fikje automatik i përhapur në ndarjen e interesuar.

Elementet konstruktive që përbëjnë ndarjet, duhet të plotësojnë kushtet e rezistencës ndaj zjarrit parashikuar në përcaktimet e pikës 19.1.

Pjesët dhe komunikimet me objektet me rrezik specifik duhet të jenë konform parashikimeve dhe specifikimeve të normave të parashikuara në akte nënligjore.

19.4 Kate nëntokësore

Kërkohet respektimi sa është parashikuar në përshkrimet e pikës 6.4 të kësaj rregulloreje.

6.4 Kate nëntokësore

Sipërfaqja e lirë në shërbim të publikut mund të jenë vendosur vetëm në kuotat minus 10,00 metër.

Për sa më sipër, zona e vendosur në kuotat -7,50 dhe -10,00 m, duhet të jetë e mbrojtur nga impiante automatike të fikjes së zjarreve me ujë, të ndara dhe të komanduara nga impiante zbulimi antizjarr.

19.5 Korridoret

Është kërkesë respektimi i përshkrimeve të pikës 6.5 me përjashtim të dyerve të dhomave, që duhet të kenë karakteristika jo më të vogla se RE 15 me sistem vetmbylljeje.

Përshkrimet relative të instalimeve të dyerve RE 15 nuk aplikohen në aktivitetet akomoduese që ndodhen në objekte jo më shumë se 3 kate mbi tokë, me një kapacitet jo më të madh se 40 shtretër dhe me një ngarkesë në çdo kat, jo më shumë se 20 kg/m² është lejuar, si alternativë, që dyert e dhomave nuk kanë karakteristika RE 15, kur aktiviteti është i mbrojtur nga një impiant automatik diktues dhe alarmi antizjarr, ky i fundit instaluar në korridor dhe në dhomat e të ftuarve.

6.5 Korridoret

Ndarjet e dhomave dhe korridoreve duhet të kenë karakteristikat e rezistencës ndaj zjarrit jo më vogël se REI 30. Dyert e dhomave duhet të jenë të karakteristikave të rezistencave ndaj zjarrit REI 30, me udhëzues për rastet e vetmbylljes.

19.6 Shkallët

Në objekte me më shumë se dy kate mbi tokë dhe me lartësi antizjarr nën 32 m, shkallët eskuzivisht duhet të jenë të tipit të mbrojtur. Në objektet me lartësi të larta, shkallët duhet të jenë të tipit të provës së tymit.

Karakteristikat e rezistencës ndaj zjarrit të hapësirës së shkallëve dhe të portës të hyrjes në shkallë duhet të jenë konform parashikimeve të pikës 19.1.

Çdo hapësirë duhet të ketë një sipërfaqe të mjaftueshme, siç është parashikuar në pikën 6.6 me minimum (1 m²).

Dhomat e të ftuarve duhet të komunikojnë me hapësirën e shkallëve përmes korridorit.

Komunikim direkt në të tilla dhoma me hapësirat e shkallëve është e lejuar, sepse rruga e përshkruar me dyer me rezistencë ndaj zjarrit të mjaftueshme me përcaktimet e parashikuara në pikën 19.1.

Në alternativë është lejuar komunikimi direkt me dhomat, me hapësirën e shkallëve sepse ngarkesa antizjarr e njëjtë, por jo më madhe se 20 kg/m² dhe me karakteristika të rezistencës ndaj zjarrit të portave të hyrjes janë të tilla me ato të hapësirave të shkallëve.

Për hapësirat e shkallëve të përdorimit të përzier me rikthim, duhet të respektohet sa është përcaktuar në pikën 20.5 (struktura akomoduese me një rrugë dalje nga një drejtim).

19.7 Ashensorët dhe ashensorët për ngarkesë

Duhet të respektohen kërkesat e pikës 6.7 të kësaj rregulloreje.

Karakteristika e rezistencës ndaj zjarrit duhet të jetë e tillë si të përcaktimet e pikës 19.1.

6.7 Ashensorët dhe ashensorët për ngarkesa

Ashensorët, ashensorët për ngarkesa nuk mund të jenë të dobishëm për rastet e zjarreve, për këtë qëllim bëjnë pjesë ashensorët antizjarr, sipas përcaktimeve të pikës 6.8. Ashensorët dhe ashensorët për ngarkesa, që nuk janë instaluar nga brenda në një shkallë të tipit të mbrojtur, duhet të jenë të tipit me kafaz të mbrojtur, me karakteristikat dhe rezistencat nga zjarri sipas përcaktimeve të pikës 6.1.

Karakteristikat e ashensorëve dhe të ashensorëve për ngarkesa duhet të përputhen me specifikimet e dispozitave në fuqi për parandalimin e zjarreve.

20. PËRMASAT PËR EVAKUIMIN NË RASTE ZJARRI

Karakteristikat e rrugëve të eksodit duhet të jenë vende në raport me karakteristikat e strukturave akomoduese dhe objekteve brenda këtyre vendndodhjeve, për sa është parashikuar në dispozitat e mëposhme.

20.1 Grumbullimet, kapaciteti i daljeve

Duhet të respektohen kërkesat e pikave 7.1 dhe 7.2, realizuar në raste zjarresh, sipas përshkrimeve të pikës 20.5 (rrugë dalje me një drejtim).

7.1 Përqendrim i personave

Përqendrimi i personave të caktuar në:

- zona të destinuara për dhoma: numri i vendeve të shtretërve;
- zona në shërbim të publikut: destinuar për grumbullime për 0,4 persona/m², shpëtuar sipas pikës 8.4.4;

- zona të destinuara për shërbim: persona të grumbulluar present për më pak se 20%.

7.2 Kapaciteti i daljeve (fluksit)

Në fund të dimensioneve të daljeve, kapaciteti i fluksit duhet të jetë jo më i madh se vlerat pasuese:

- 50 persona për kate tokësore;
- 37,5 persona për kate nëntokësore;
- 37,5 persona për objekte deri në tre kate;
- 33 persona për objekte mbi tre kate.

Në alternativë është lejuar adaptimi me kapacitet daljeje, për jo më shumë se 37,5 persona për mbi tre kate mbi tokë, me prezencë të treguesve dhe sinjalizuesve antizjarr e njëjtë për gjithë aktivitetin, me përjashtim që në dhomat e hoteleve deri në 100 shtretër të jenë pajisur me dyer RE 15 me karakteristika e pajisje vetmbyllëse.

Lejohet të adaptohet, për çdo kat ndryshe nga katet nëntokësore, kapaciteti i daljeve, për jo më shumë se 50 shtretër, pas plotësimit të këtyre kushteve:

a) të instalohet një impiant tregues, diktues dhe sinjalizues antizjarr i njëjtë brenda aktivitetit akomodues;

b) adaptimi i shkallëve të mbrojtura;

c) dalje e ndryshme e jashtme direkt nga shkalla e mbrojtur.

20.2 Gjerësia e rrugëve të daljes

Është e nevojshme që në fund të daljes, shkallët dhe sheshpushimet të kenë largësinë minimale 0,90 m, llogaritur me modulën në fund të përlllogaritjeve të fluksit të daljeve.

Janë lejuar ngushtime të hapësirave në objekt, sepse largësia minimale e plotë, kuptimi i tolerancës, të mos jetë nën 0,80 m, me kondicionet që gjatësia e rrugëve të daljes të jenë pranishme vetëm me materiale të klasit 0 të reaksionit ndaj zjarrit. Dhe është lejuar si përjashtim vetëm rruga e ecjes qendrore, e cila lejohet me materiale të klasit 1 ndaj reaksionit të zjarrit.

Zonat ku janë parashikuar prania e personave me reduktim ose bllokime me kapacitete motorike duhet të jenë parashikuar rrugë, të cilat duhet të përputhen me rregullat në fuqi për materialet e përdorura, si dhe me eliminimin e barrierave arkitektonike.

20.3 Gjerësia totale e daljeve

Gjerësia totale e daljeve duhet të verifikohet sipas parashikimeve të pikës 7.6 me përjashtim të strukturave akomoduese që kanë një shkallë për përdorim.

7.6 Gjerësia totale e daljeve

Gjerësia totale në çdo kat shprehur në numër modulesh, është e përcaktuar nga raporti në mes maksimumit të grumbullimeve parashikuar në kapacitetet e fluksit të kateve.

Për strukturat që kryejnë veprimtari akomoduese dhe që zënë më shumë se dy kate mbi tokë, gjerësia totale e rrugëve të daljes që vendosen në hyrje, vjen e llogaritur duke shtuar maksimumin e grumbullimeve të parashikuar në dy kate pasuese, me referimin e vlerave madhore të mbivendosjes.

Në brendësi të gjërësisë së daljes janë mbështetur portat e hyrjes, kur këto janë të hapshme në drejtim të daljes.

Është e këshillueshme të instalohen këto lloj portash hyrjeje:

c) tip i rrotullueshëm, nëse pranë është instaluar një portë e hapshme, e shtytshme në drejtim të jashtëm me karakteristikat e daljes.

d) tip i rëshqitshëm me lëvizje automatike, veçanërisht të jenë të hapshme me të shtyrë kur mungon ushqimi elektrik.

Shkallët e lëvizjes nuk duhet të parashikohen në gjerësinë e daljes.

20.4 Rrugët e daljes dhe përdorimi përjashtues

20.4.1 Objekte që shërbejnë me dy ose më shumë shkallë

Përshkrimi i daljeve, kjo e llogaritur nga nisja, nga dera e çdo dhome në çdo pikë të gjithë objektit nuk duhet të jetë më shumë se:

a) 40 m: për arritjen e një daljeje në hapësirën e qetë ose në shkallën të sigurisë së jashtme.

b) 30 m: për arritjen e një shkalle të mbrojtur, që bën pjesë në sistemin e rrugëve të daljes.

Thellësia e korridorit të verbër nuk mund të jetë mbi 15 m.

Sa më sipër, thellësia mund të shtohet me 5 m kur janë realizuar dhe respektuar këto rregulla shtesë që korespondojnë me rrugën e interesuar:

- materialet e instaluar në muret ndarës dhe tavane janë të klasës 0 të reaksionit ndaj zjarrit, dhe jo materiale që marrin dhe janë të djegshme në njërën anë.

- janë instaluar gjatë rrugëve të daljes dhe në dhoma, një impiant automatik diktimi dhe alarmi antizjarr.

Rruga e daljes e llogaritur nga nisja e çdo dere të dhomave në çdo pikë të objektit, nuk mund të jetë më pak se 5 m dhe me përjashtim të korridorit të verbër me kushtet që:

- të gjitha materialet e instaluara në të tilla rrugë janë të klasit 0 të reaksionit ndaj zjarrit, përjashtim mund të bëjë rruga e ecjes qendrore, që për të lejohet klasa 1 të reaksionit ndaj zjarrit.

- dyert e dhomave në të tilla rrugë kanë karakteristika RE 30, si dhe janë të parashikuar me sisteme vetmbylljeje.

Limitet e korridorit të verbër janë të lejuara me një thellësi prej 25 m, me kusht që:

- të gjitha materialet e instaluara në të tilla korridore të jenë të kalsës 0 ndaj reaksionit të zjarrit;

- dyert e dhomave që janë në këto korridore, kanë karakteristika RE 30 dhe janë vendosur me sistem vetmbyllës;

- është instaluar një impiant automatik diktimi dhe alarmi antizjarr më dhoma dhe korridore.

Për limitet e korridorit të verbër është lejuar një thellësi maksimale 30 m, me kushte të mëtejshme të tilla që ngarkesa antizjarr në dhoma të jetë jo më shumë se 20 kg/m².

Në harmoni me komunikimin e kateve nëntokësore, si dhe me boshllëkun e shkallëve duhet të jenë instaluar dyer, që kanë karakteristika të rezistencës ndaj zjarrit jo më vogël se REI 60, pajisur me mekanizëm të mbylljes automatike.

20.4.2 Objekt që shërben me një shkallë të vetme

Është lejuar kufizimi në strukturat akomoduese i vendndodhjes në objekteve me më pak se 6 kate mbi tokë, të vendoset një shkallë e vetme. Kjo duhet të jetë e tipit të mbrojtur në objektet me më shumë se dy kate mbi tokë.

Në alternativë për aktivitetet akomoduese, vendodhja e objekteve që kanë lartësinë antizjarr jo më shumë se 32 m, është parashikuar instalimi i një shkalle, me kusht që:

a) shkalla të jetë e tipit të provës së tymit nga jashtë, apo

b) shkalla të jetë e tipit të mbrojtur ku është instaluar një impiant i fikjes automatike i njëjtë për aktivitetin e brendshëm.

Në alternativë, për aktivitetet akomoduese vendndodhja e objektit me lartësi antizjarr jo më shumë se 24 m, me kufij 6 kate mbi tokë dhe për katet më të ulëta se kati i gjashtë, sido që ka lidhje në banesat për të ftuarit dhe për personat e pranishëm, në hapësirat e përgjithshme për publikun, është lejuar instalimi i një shkalle të vetme, me kusht që:

a) shkalla të jetë e mbrojtur dhe të ketë karakteristika ndaj zjarrit me përshtatshmëri për sa është parashikuar në pikën 19.1;

b) soletat ndërmjet kateve të 6 dhe 7 të jenë të rezistencës ndaj zjarrit me karakteristika të përshtatshme sa është parashikuar në pikën 19.1;

c) është parashikuar një impiant automatik diktimi dhe sinjalizimi antizjarr i njëjtë, me atë në brendësi të aktivitetit.

Për aktivitetet akomoduese, vendndodhja e objekteve për lartësinë antizjarr jo më të madhe se 24 m, e njëjtë me 6 kate mbi tokë është vendosur instalimi i një shkalle të vetme, me kusht që:

a) shkalla të jetë e mbrojtur dhe të ketë karakteristika të rezistencës ndaj zjarrit të përshtatshëm me përshkrimet e pikës 19.1, si dhe të jetë garanci për afrimin e autoskallës të PMNZSH-së, apo prova e tymit të ketë karakteristika të barabarta me rezistencën e zjarrit;

b) sipërfaqja totale e çdo kati ngjitur me shkallët (ekskluziv i kateve tokësore dhe kateve të para që përdoren për salla restorantesh, pritjeje ose hapësira për publikun) nuk janë më të mëdha se 350 metër katrorë, llogaritur direkt me sipërfaqen e terracës ku vendosen shkallët;

c) rruga e katit ndërmjet dyerve të dhomave dhe shkallët me kufij 20 metra me kushte që gjatë rrugës materialet e instaluara të soletave, mureve ndarës të jenë të klasit 0 të rezistencës ndaj zjarrit;

d) dyert e dhomave të gjashtë kateve të kenë karakteristika RE 30 me parashikime të vetmbylljes;

e) të jetë instaluar një impiant automatik diktimi dhe sinjalizimi antizjarr i njëjtë për gjithë aktivitetin;

f) soletat e katit kanë karakteristika të rezistencës ndaj zjarrit përputhshëm me sa është parashikuar në përshkrimet e pikës 19.1.

Thellësia e korridorit ku vendosen shkallët duhet të respektojnë limitet nga 15 m deri në 20, ose 25 m kur janë realizuar parashikimet e përshkruara në pikën 20.4.1, me vendosjen e impiantit të diktimit-sinjalizimit dhe alarmit antizjarr në të gjithë aktivitetin. Është pranuar që thellësia maksimale e korridoreve ku vendoset shkalla të jetë 30 m, me minimum kushtesh që ngarkesa antizjarr në dhoma që janë afër korridorit, si dhe të mos jetë më shumë se 20 kg/m².

Komunikimi i hapësirave të shkallëve me katet nëntokësore mund të afrohet eskuzivisht nëpërmjet sigurimit, me dyer të tipit REI 60 pajisur me mekanizëm me vetmbyllje.

Kufijtë për objekte deri në 3 (tre) kate mbi tokë, nuk lejohet realizimi i shkallëve të tipit të mbrojtur me kusht që:

- të gjitha pjesët e objektit të aktivitetit janë të mbrojtura nga impiante automatike diktimit-sinjalizimi dhe alarmi antizjarr;

- ngarkesa antizjarr për çdo kat, duhet të jetë më pak se 20 kg/m², me përjashtim të depozitave që duhet të jenë konform përshkrimeve të pikës 8.1;

- thellësia e korridoreve që paraqesin shkallët në kufij të limituar 20 m, gjejnë zbatim parashikimet e pikës 20.4.1.

Nuk pranohet realizimi i shkallëve të tipit të mbrojtur për objekte në katër kate mbi tokë, me zgjedhje të një prej parametrave të mëposhtëm:

a) realizimi i shkallëve dhe i korridoreve, ku bashkohen shkallët me materiale të klasës 0 të reaksionit ndaj zjarrit, si dhe përjashtim eventual bën rruga për ecje qendrore realizuar me materiale të klasës 1 të reaksionit ndaj zjarrit, si dhe instalimi i dyerve të paktën RE 15 për mbrojtjen e dhomave; instalimi në dhoma i shtretërve me materiale të klasës 1 të reaksionit ndaj zjarrit dhe jastëk, karrike, poltronë, poltronë shtretër, divanë, divanë shtretër përmblihen në klasin 1 IM;

b) realizimi i shkallëve dhe i korridoreve, ku bashkohen shkallët me materiale të klasës 0 të reaksionit ndaj zjarrit, eliminon komplet shkallët e njëjta dhe korridoret e çdo materiali të djegshëm, me përjashtim të rrugës qendrore të objektit, ndërtuar me materiale të klasës 1 të reaksionit ndaj zjarrit, si dhe instalim i dyerve të paktën për mbrojtjen e dhomave.

Vendqëndrimet për ambientet e shërbimit kur shkallët nuk janë të tipit të mbrojtur, me kusht që thellësia e rrugëve për të arritur në vendin e sigurt është e limituar në 40 ose 45 m sipas specifikimeve të pikës 20.4.1.

20.4.3 TREME E HYRJES

Në rastin kur shkallët futen në tremën e hyrjes, kur kjo situatë përbën pjesë të kalimit të eksodit, në këto kushte duhen respektuar dispozitat e mëposhtme:

- materialet e instaluar në tremën e hyrjes duhet jenë konform përcaktimeve sa është parashikuar në pikën 6.2 germa "a", ose të klasës të reaksionit të zjarrit jo më të madhe se 1, në shkallën 50 % të maksimumit të sipërfaqes të tyre totale (dysHEME+parete+tavanë+projeksion horizontal i shkallëve); për pjesët e mbetura duhet të përdoren materiale që nuk ndizen; në një ambient të tillë nuk duhet të instalohen aparatura nga të cilat mund të rrjedhin rreziqe për zjarr; atëherë kur në tremën e hyrjes është parashikuar një zonë për "bar" është lejuar instalimi i makinës "kafe" të tipit elektrik;

- në rastin kur është lejuar që shkallët të jenë të pambrojtura, gjatësia e kalimit total, duke u nisur nga kati më i lartë deri në daljen përjashta, duke përfshirë këtu edhe pjesën e tremës së hyrjes së interesuar, duhet të jetë jo më lartë sa është parashikuar në paragrafin e pikës 20.4.2.

- në rastin kur shkallët janë të tipit të mbrojtur dhe kur zbritja e privuar pa mbrojtëse, kalimi nga zbritja deri jashtë duhet të jetë jo më e madhe se 15 m dhe trema e hyrjes duhet të jetë e ndarë nga lokalet më të afërta me struktura REI 30 dhe me porta komunikimi RE 30 të pajisura me dispozitiva vetmbyllëse; gjatësia e kalimit mund të arrihet deri në një maksimum prej 25 m me kushtin që të gjitha materialet e instaluara në vendin e hyrjes dhe në lokalet e afërta të jenë të mbrojtura nga një impiant automatik diktimi dhe sinjalizimi të zjarreve.

20.5 Rrugët e daljes me përdorim të ndryshëm (të përzier)

Është lejuar qëndrueshmëria e strukturave akomoduese të objekteve në ndërtesa me destinacion të përzier, që kanë shkallë me përdorim të përzier në kushtet e mëposhtme:

- komunikimet e pjesës bosh të shkallës në katet kantine dhe me aktivitetet që lidhen me parandalimin e zjarreve të vendosura në ambientet e ndërtesës në bazë të pikës 5.1 germa “b” kryhet nëpërmjet dyerve me rezistencë ndaj zjarrit REI 60;

- ndërtesa të ketë lartësi antizjarr jo më të madhe se 24 m, si dhe të ketë lartësi antizjarr jo më të madhe se 32 m, me kusht që i gjithë aktiviteti dhe materialet e riveshjes dhe ato që mund të marrin flakë të jenë të klasës 1 të reaksionit të zjarrit, si dhe mobiljet dhe dyshekët të jenë të klasës 1 IM të reaksionit ndaj zjarrit;

- shkallët duhet të jenë të pajisura me impiante të ndriçimit të sigurisë;

- e gjithë zona e aktivitetit akomodues të jetë e mbrojtur nga impiante automatike të diktimit dhe sinjalizimit ndaj zjarrit;

- aktiviteti akomodues të jetë shpërndarë në çdonjërin nga pjesët përbërëse, duke përfshirë dyert e hyrjes dhe hapësirat e shkallëve të kenë karakteristika të rezistencës ndaj zjarrit të paktën REI 60; është lejuar prania e ambienteve pritëse që komunikojnë me pjesë të përbashkëta të ndërtesës, me kusht që:

- ky ambient të jetë në mënyrë të vazhdueshme i kontrolluar;

- ngarkesa e zjarrit të jetë më e vogël se 10 kg/m²;

- sipërfaqja të jetë më e vogël se 20 m²;

- nuk janë të pranishme substancat e ndezshme;

- ngarkesa e zjarrit në brendësi të ndarjeve nuk duhet të jetë më e madhe se 20 kg/m²;

- gjatësia e shkallës dhe e rrugës së eksodit të llogaritet nga kati i popullimit maksimal, ku është vendosur aktiviteti akomodues.

Nga ana tjetër, në varësi të numrit të shkallëve, duhet të kihet parasysh si më poshtë:

- çdo kat ka dy ose më shumë shkallë: kalimi maksimal nga dera e dhomës në shkallët e ndërtesës të mos jetë më i madh se 25 m; korridori i verbër nuk mund të kalojë gjatësinë e 15 m; lejohet kalimi maksimal nga dera e dhomës deri te shkallët e ndërtesës të mos i kalojë 30 m dhe që korridoret e verbra kanë një gjatësi maksimale jo më të madhe se 20 m, me kusht që, gjatë kalimeve të evakuimit, materialet e instaluara në mure, parete, dysheme të jenë të klasës 0 të reaksionit ndaj zjarrit, si dhe dyert e dhomave të kenë karakteristika ndaj zjarrit RE 30;

- çdo kat të ofrojë shërbimin vetëm nga një shkallë: aktiviteti akomodues të jetë i shpërndarë në pjesë (ndarje) që kanë sipërfaqe jo më të madhe se 250 m²; kalimi maksimal për të arritur shkallën nga dyert e çdo dhome të mos i kalojë 15 m; lejohet që aktivitetet akomoduese të jenë shpërndarë në ndarje jo më të mëdha se 350 m² dhe që kalimi maksimal nga shkalla për të arritur shkallën, nga dera e çdo dhome të mos jetë më e madhe se 20 m, me kusht që gjatë kalimeve materialet e instaluara në soleta, parete, mure, dysheme të jenë të klasës 0 të reaksionit ndaj zjarrit, si dhe dyert e dhomave duhet të kenë karakteristika ndaj zjarrit të paktën RE 30.

21. DISPOZITA TË TJERA

21.1 Dispozita teknike

Aktivitetet ekzistuese duhet të respektojnë përshkrimet në pikat 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, të kësaj rregulloreje.

8. Zona dhe impiante me rrezik të veçantë

8.1 Objekte të përcaktuara për depozita

8.1.1 Objekte me sipërfaqe jo më të vogël se 12 m², destinuar për magazinimin e materialeve të djegshme

Mund të jenë të vendosura edhe në sipërfaqe të brendshme (dhome). Strukturat ndarëse deri sa të paktën të kenë karakteristika REI 60, si dhe të jenë të pajisura me pajisje vetkryçëse. Ngarkesa e flakës duhet të jetë kufizuar në 60 kg/m² dhe duhet të jetë instaluar në to një impiant automatik lajmërimi alarmi për zjarret. Ventilimi natyral nuk duhet të jetë më pak se 1/40 e sipërfaqes së objektit.

Në qoftë se nuk është e mundur të arrihet ajrimi natyral i raportit të mësipërm, realizohen dy ajrime mekanike, në prurjen e dy orareve të garantuara edhe në rastet e emergjencave, deri sa të sigurohet një sipërfaqe ajrimi e barabartë me 25% të asaj të parashikuar.

Pranë dyerve të dhomave, duhet të jetë instaluar një fikës zjarri.

8.1.2 Objekte me sipërfaqe maksimumi 500 m², destinuar për magazinimin e materialeve të djegshme

Mund të jenë të vendosura edhe në sipërfaqe nëntokësore në brendësi të ndërtesës duke përfshirë sipërfaqet e dhomave. Strukturat ndarëse deri sa të paktën të kenë karakteristika REI 90 dhe të jenë të pajisura me pajisje vetkryçëse. Ngarkesa e flakës duhet të jetë e kufizuar në 60 kg/m² dhe duhet të jetë instaluar në të një impiant automatik alarmi për lajmërimin e zjarrit. Ventilimi natyral nuk duhet të jetë më pak se 1/40 e sipërfaqes të objektit.

8.1.3 Depozitat e substancave të lëndëve të djegshme

Duhet të jenë të vendosura në më pak se volumi i fabrikuar. Është këshillueshme të sistemohen në brendësi të ndërtesës nëpër dollapë metalikë të përshtatur në rezervuare me lëndë antizjarr, në kushte të përshtatshme higjeno-sanitare. Dollapë të tillë duhet të jenë vendosur në objektet magazinë.

8.2 Shërbime teknologjike

8.2.1 Impiante të prodhimit të nxehtësisë

Impiantet e nxehtësisë duhet të jenë të tipit të përqendruar (qendror). Të tilla impiante duhet të jenë realizuar sipas rregullave të përpikta, duke respektuar specifikimet teknike për parandalimin e zjarrit. Në fshatrat turistike dhe në rezidenca me veprimtari akomoduese, është e këshillueshme sipas destinacionit specifik, që grumbullimet e veçanta të banesave të jenë shoqëruar nga impiante individuale për ngrohje ambienti, ose gatimi ushqimesh me gaz djegës për kontrollin e kushteve të poshtëshënuara:

a) aparatet dhe impiantet e gazit, sipërfaqet e ajrimit dhe kanalizimet e shkarkimeve të gazrave duhet të jenë realizuar sipas rregullave të përcaktuara strikte konform rregullave të sigurisë në fuqi;

b) aparatet e ngrohjes së ambientit dhe të prodhimit të ujit të ngrohtë ushqyer me gaz duhet të vendosen jashtë;

c) çdo vatër djegëse e gazit duhet të jetë e pajisur me dubël saraçineskë për ndërprerjen e fluksit të gazit për rastet e fikjes së flakës;

d) kontaktorët ose bombulat e ushqimit me gaz të djegshëm duhet të jenë vendosur jashtë banesës, (për depozita të vendosura mbi tokë me kapacitet deri në 3 metër kub, distanca nga objekti duhet të jetë mbi 5 metër; për depozita me kapacitet deri në 5 metër kub, distanca nga objekti nuk duhet të jetë më pak se 10 metër).

e) fuqia termike që sjellin aparatet e ushqimit me gaz duhet të jenë kufizuar në vlerën e 34,89 kW (30000 Kcal/h);

f) aparatet duhet të jenë objekt i një mirëmbajtjeje të rregullt dhe instruktimesh dhe për përdoruesit e tyre duhet të jenë të qarta.

8.2.1.1 Shpërndarja e gazit të djegshëm

Tubacionet qendrore të gazit të djegshëm duhet të jenë vendosur në pamje të jashtme e të dukshme të ndërtesës. Në alternativë, për rastet e gazit me dentisitet relativ më të vogël se 0,8, është lejuar sistemimi i drejtë në zonën me pikën më të lartë. Në objekte duhet pranuar nëpërmjet tubacioneve që duhet të jenë të reaksionit ndaj zjarrit të klasit zero, me diametër superior të paktën 2 cm, si dhe duke respektuar tubacionet e brendshme. Tubacionet kryesore të gazit duhet të jenë sipas parametrave dhe me vetmbyllje automatike, në situatë rrjedhjeje. Gjithashtu, tubacionet duhet të kenë instaluar sinjalistikë treguese për praninë e gazit.

8.2.2 Impiante të kondicionimit dhe të ventilimit

Impiantet e kondicionimit dhe të ventilimit mund të jenë qendrore ose të lokalizuara. Të tilla impiante duhet të kenë të nevojshme kushtet që të garantojnë arritjet e këtyre objektivave:

- a) të mbajnë në efikasitet ndarjet e objektit;
- b) të evitojnë riciklimin e produkteve të djegshme ose gazrave të tjera të rrezikshme;
- c) të mos shkaktjnë probleme avarie ose prishje të ajrit, si dhe të mos e përhapin atë në objektet ngjitur;
- d) të mos krijojnë elemente përhapje të tymit ose të flakës në fazën e fillimit të zjarreve.

Të tilla objektiva konsiderohen të drejta për impiantet si këshilla specifike.

8.2.2.1 Impiante qendrore

Pjesët në trajtim të hapësirave dhe të grupeve frigoriferike nuk mund të jenë instaluar në objekte, ku janë instaluar impiante të prodhimit të nxehtësisë.

Grupet frigoriferike duhet të jenë instaluar në shtesa objektesh të ndërtuara në struktura të veçanta të karakteristikave me rezistencë ndaj zjarrit jo më të vogël se REI 60 me dalje të drejtëpërdrejtë nga jashtë ose nëpërmjet rrugëve të shkarkimit të zonave të daljes me karakteristika analoge, të paktën ku portat e kanë rezistencën ndaj zjarrit REI 60 dhe të jenë të pajisura me sistem vethapës nga brënda.

Hapësirat në objekte ku janë instaluar grupet frigoriferike me sipërfaqet minimale që ato zënë, nuk duhet të jenë më pak se 1/20 e sipërfaqes së përgjithshme të objektit. Grupet frigogjene duhet të shfrytëzohen si lëngje rrjedhëse, prodhime jo të djegshme dhe jo helmuese. Grupet frigoriferike që prodhojnë solucione ujore të amoniakut, mund të jenë të instaluar vetëm jashtë objektit ose në objekte ngjitur me karakteristika analoge të centraleve termike të ushqyer me burime gazi.

Centralet frigoriferike të destinuara për mbajtje grupesh termofrigoriferike me thithje të nxehtësisë direkte, duhet të respektojnë dispozitat për parandalimin e zjarreve në fuqi, për impiantet e prodhimit të nxehtësisë, referuar tipeve të djegshëm në përdorim.

Nuk është pranuar shfrytëzimi i ajrit të ricikluar në kuzhinë, garazh dhe çdo hapësirë me rrezik specifik.

8.2.2.2 Ujësjiellësi

Ujësjiellësi duhet të jetë realizuar me materiale të klasës 0 (zero) të reaksionit ndaj zjarrit. Tubacionet freksibël dhe rekordet duhet të jenë të klasës të reaksionit ndaj zjarrit jo më të madhe se klasi 2².

Ujësjiellësi nuk duhet të përshkojë:

- vende të pasigurta, që janë në qiell të hapur;
- hapësirat e shkallëve dhe hapësirat e përcaktuara për ashensorë;
- objekte që paraqesin rrezik për zjarr, shpërthime dhe plasje.

Ujësjiellësit përshkojnë struktura rezistente të zjarrit të klasës të paktën të barabartë në këto hapësira që përmenden më sipër.

Ujësjiellësit duhet të jenë mbyllur me materiale të rezistencës ndaj zjarrit të klasës 0, pa pengesa gjithandej dhe me zgjerim të njëjtë.

8.2.2.3 Sistemi i kontrollit

Çdo impiant duhet të jetë pajisur me sistemin e komandimit manual, situatë e një pike lehtësisht të kuptueshme, për ndalimin e ventilatorëve në rast rreziku.

Gjithashtu, impiantet që riciklojnë ajrin, në shërbim të më shumë pjesëve ndarëse të objektit pajisur në brendësi të ujësjellësit, me tregues të tymit që komandon automatikisht ndalimin e ventilatorëve dhe mbyll (brezin kundër zjarrit). Ndërhyrja e treguesit duhet të jetë sinjalizuese në qendrën e kontrollit, siç përshkruhet në pikën 12.2.

Ndërhyrja në sistem, qoftë manuali ose automatiku, nuk duhet pranojë rivënjen të prishur të ventilatorëve pa ndërhyrë manuali i operatorit.

8.2.2.4 Skemat funksionale

Për çdo impiant duhet të jetë parapërgatitur një skemë funksionale, në të cilën shpjegohet:

- vendkalimet e strukturave rezistente ndaj zjarrit;
- vendndodhjet në brendësi të zjarrpenguese (brezat kundër zjarrit);
- vendndodhja e ventilatorëve të tymit dhe komandat manuale (automatike);
- skemat e fluksit të ajrit parësore dhe sekondare;
- logjika momentale e manovrimit të veprimeve në rastet e emergjencave.

8.2.2.5 Impiantet lokale

Është pranuar si kushtëzim që ajri në gjysmë të kondicionerëve, në kondensim gazi frigoriferik të mos jetë i ndezshëm. Ky është eskluzivisht detyrim, që aparaturat të ndërhyjnë në zjarr të lirë.

8.3 Garazhet

Garazhet në shërbim të veprimtarisë turistike duhet të jenë realizuar konform me limitet e parandalimit të zjarrit parashikuar në dispozitat në fuqi.

8.4 Hapësirat për mbledhje, argëtim, pritje dhe të ngjashme me to.

Në objekte me të tilla hapësira, të frekuentuara nga publiku, të ftuarit ose jo, në aktivitete hapur brenda caqeve të një objekti ose kompleksi turistik destinuar për dëfrim, argëtim pritje apo mbledhje, aplikohen normat pasuese për parandalimin e zjarreve. Titulli i ilustruar më sipër mund të përfshijë:

- konferenca;
- takime;
- sfilata mode;
- mbledhje gostie;
- pak spektatorë për kabare;
- festa vallëzimi;
- ekspozita arti, merceologjie etj.

8.4.1 Vendndodhja

Objektet (lokalet) e dëfrimit mund të ndodhen pothuajse në kuotat e mbikatis të nivelit të rrugës dhe të kateve të poshtme, jo më shumë se thellësia 10 metër nga kati i rrugës.

8.4.2 Komunikimi

Objektet (lokalet) e dëfrimit me kapacitet më të vogël se 100 persona mund të komunikojnë direkt me ambientet që ushtrojnë aktivitet akomodues turistik, sipas normave, tregues të zonave me rrezik specifik.

Për objektet e tjera, të treguara në komunikim me ambiente të tjera të aktivitetit turistik, duhet të jenë vendosur nëpërmjet portave me rezistencë ndaj zjarrit REI 30. Sepse kjo gjë nuk bie në kontrast me normat për parandalimin e zjarreve relative në zonat me rrezik specifik.

8.4.3 Strukturat e materialeve

Për sa në lidhje me kushtet e rezistencës ndaj zjarrit të elementeve strukturale dhe të karakteristikave të reaksionit ndaj zjarrit të materialeve të përdorura, si dhe të mobiljeve, duhet të përputhen me përshkrimet e përcaktimeve të pikave 6.1, 6.2.

8.4.4 Përmasat për evakuim në raste emergjencash

Grumbullimet maksimale të hipotezuara, në këto objekte, në të cilën publiku gjendet në vende ose i ulur, shpërndarë në grupe e sektorë vjen e fiksuar së pari nga numri i vendeve të karrikeve. Në raste të tjera vjen e fiksuar barabartë kur rezultati i ulët dhe dëntisiteti i grumbullimit nuk është më i madh se 0,7 persona për m² dhe në çdo rast duhet të jetë deklaruar nën përgjegjësinë direkt të titullarit të aktivitetit. Objektet duhet të jenë vendosur në një sistem organizimi të rrugëve të eksodit për personat konform rregullave në fuqi dhe këtyre përshkrimeve:

d) objekte me kapacitet mbi 100 persona: duhet të jetë shërbyer për të dalë që, për numër e dimension janë konform normave në fuqi mbi këto objekte për spektakle dhe ngjashme me to. Të paktën gjysma e daljes duhet të paraqesë direkt së jashtmi vendin e qetë, të sigurt e dinamik. Ndërsa të tjerët mund të futen në sistemin e rrugëve të daljes së evakuimit të katit.

e) objekte me kapacitet të përgjithshëm midis 50 dhe 100 persona: duhet të jenë të pajisur të paktën me dy dalje, me thellësi konform normave në fuqi për parandalimin e zjarreve, për objektet në përdorim të publikut për spektakle, që futen në sistemin e rrugëve të evakuimit daljeve në kat.

f) Objektet me kapacitet më të vogël se 50 persona: është e lejuar që këto objekte që janë në shërbim me një dalje për evakuim të vetme, gjerësia nuk duhet të jetë më e vogël se 0,90 m, që futet në sistemin e rrugëve të daljes në kat.

8.4.5 Vendosja e vendeve për t'u ulur

Vendosja e vendeve për t'u ulur duhet të jetë konform normave në fuqi, me përjashtim të objekteve të destinuara për kërcime festive, mbledhje të përbashkëta etj, për të cilat është e këshillueshme që karriket të mos jenë të bashkuara midis tyre dhe të tjerat të jenë të ndara sipas nevojave të rastiit, me kusht që të mos përbëjnë pengesë për daljen e personave në raste emergjence.

9. Impiantet elektrike

Impianti elektrik duhet të jetë realizuar konform akteve ligjore dhe normave të sigurisë teknike në fuqi.

Në veçanti për parandalimin e zjarreve, impiantet elektrike:

- nuk duhet të krijojnë premisë për zjarr dhe shpërthim;

- nuk duhet të krijojnë burime ose rrugë ushqimi, që favorizojnë shpërndarjen e zjarrit.

Ndarjet e zjarrit të mbulesës duhet të jenë ndarë me destinacion specifik përdorimi të objektit;

- mund të jenë të mbindarë në mënyrë të tillë, që një prishje e mundshme e impiantit të mosprovokojë nxjerrjen e impiantit jashtë shërbimi të gjithë sistemin.

- të jenë vendosur, pajisur aparatura manovrave të vendosura në pozicion "mbrojtje", ku duhet të vendosen qartë treguesit e qarqeve që i përkasin (të shënuara).

Rregullat e mëposhtme duhet të shoqërojnë impiantet e sigurimit:

a) ndriçimi;

b) alarmi;

c) zbulim, tregim të papritur;

d) impiantet e fikjes së zjarreve;

f) pajisjet kundër zjarrit.

Ushqimi i siguresave duhet të jetë me shkëputje automatike të shkurtra, më të vogla ose të barabarta me 0,5 sekonda për impiantet e shpërndarjes, alarmit, ndriçimit dhe ndërprerja mesatare më e vogël dhe e barabartë se 15 sekonda për pajisjet antizjarr dhe impiantet hidrike antizjarr.

Mekanizmi i karikimit të baterive (akumulatorëve) duhet të jetë i tipit automatik, i tillë që të shpërndajë karikimin komplet brenda 12 orësh.

Pavarësia e ushqimit të siguresave duhet të përmbajë përmbushjen e sigurtë të ndihmës së shpejtë dhe të fikjes në kohën e nevojshme; për çdo rast pavarësia minimale vjen e stabilizuar për çdo impiant si më poshtë:

- lajmërimi, zbulimi, alarmi: 30 minuta;

- ndriçimi i sigurimit: 1 orë;

- pajisjet antizjarr: 1 orë;
- impiantet hidrike antizjarr: 1 orë.

Instalimet e grupeve elektrogjene duhet të jenë konform normave teknike të përcaktuara në fuqi.

Impiantet e ndriçimit të sigurimit duhet të sigurojnë një nivel ndriçimi jo më të vogël se 5 luks në një metër lartësi nga kati i shkelur të rrugëve të daljes.

Vendosen llampa teke me ushqim të pavarur, por që sigurojnë funksionimin të paktën një orë.

Kuadri elektrik i përgjithshëm duhet të jetë vendosur në pozicion të dukshëm, lehtësisht të përdorshëm, sinjalizuar me tregues dhe i mbrojtur nga zjarri.

9.1 Rrufepritësit

a) Për të evituar rrezikun e zjarrit që mund të vijë nga shkarkimet atmosferike, objektet e klasifikuara në dispozitën 1 të këtij vendimi, detyrimisht pajisen me sistemin mbrojtës për shkarkimet atmosferike.

b) Ndërtohet mbi bazë të një studimi i cili është pjesë e projektit teknik që shoqëron dokumentacionin e objektit.

c) Këtij sistemi i bëhet kontrolli çdo 6 muaj për gjendjen teknike, ku të dhënat pasqyrohen në rregjistrin e kontrolleve.

10. Sistemi i alarmit

Objektet apo pjesë të tilla të destinuar për aktivitet akomodues pritës, duhet të jenë të mbrojtura nga një sistem alarmi akustik, në gjendje të paralajmërojë të ftuarit dhe personelin present në kushtet e rrezikut të rënies së zjarrit.

Pajisjet zanore duhet të kenë karakteristika dhe vendosje të tillë, që të mund të sinjalizojë rrezikun të gjithë punonjësve të pranishëm, ose pjesëve që përfshihen nga zjarri.

Komandimi i funksioneve të njëkohme i të gjitha pajisjeve zanore duhet të jetë vendosur në ambient mbizotërues, nën kontrollin e vazhdueshëm të personelit përkatës; mund të jetë parashikuar një komandë e dytë e centralizuar e vendosur në një ambient që nuk ka rreziqe të veçanta zjarri.

Për ndarjet e impianteve fikëse të zbulimit dhe të sinjalizimit të zjarrit, sistemi i alarmit duhet të funksionojë automatikisht si në rastin e përkthuar në pikën 12.

Funksionimi i sistemit të alarmit duhet të jetë i garantuar edhe në rastin mungesës së ushqimit elektrik kryesor, për një kohë jo më të vogël se 30 minuta.

11. Mjetet dhe impiantet e fikësve të zjarrit

11.1 Të përgjithshme

Aparaturat e impianteve të fikjes së zjarrit duhet të jenë realizuar konform normativave standarde të miratuara, si dhe në normat ndërkombëtare të konformitetit.

11.2 Fikësit e zjarrit

Gjithë aktiviteti akomodues turistik duhet të jetë pajisur në përputhje me numrin e fikësve të lëvizëshëm. Fikësit e zjarrit duhet të jenë të harmonizuara dhe të certifikuara konform kritereve të përcaktuara në një nga vendet e Komunitetit Europian.

Fikësit e zjarrit duhet të jenë shpërndarë në mënyrë uniforme në hapësirën për mbrojtje; sidoqoftë të paktën njëri nga fikësit të gjendet:

- përbri pajisjeve që mund të shërbejnë si ndezës zjarri;
- afër zonave me potencial rreziku zjarri.

Fikësit e zjarrit duhet të ndodhen në pozicione lehtësisht të arritshme dhe të kapshme, si dhe të shikueshme. Mbishkrimi i udhëzuesit tregues në fikësin e zjarrit duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm në distancë. Fikësit portativë duhet të jenë instaluar në propocion të çdo 200 metrave katror të dyshemesë ose pjesë fraksioni me një minimum një fikës për çdo kat.

Fikësit e zjarrit portativë duhet të kenë kapacitet shuarje jo më të vogël se 13A-89B; për mbrojtjen e hapësirave dhe impiateve me rrezik specifik duhet të jenë parashikuar fikës të tipit të përshtatshëm. Për aktivitet akomoduese deri në 25 shtretër është i mjaftueshëm instalimi i një fikësi të vetëm.

11.3 Impiante hidrike antizjarr

Hidrantët, duhet të jenë përgjithsisht të pajisur:

- shpërndarë në mënyrë të pranuar për të ndërhyrë në të gjitha hapësirat e aktivitetit;
- vendosur në çdo kat në hapësirat me shumë kate;
- diskokuar në pozicione lehtësisht të arritshme e të kapshme. Mbishkrimi i udhëzimit tregues të jetë i lexueshëm me lehtësi në distancë.

Hidrantët nuk duhet të jenë vendosur në vende brenda shkallëve, në mënyrë që të mos pengojë eksodin e personave. Prezenca e shkallëve të provës së tymit të brendshëm në fund të lejojë lehtësisht operacionin e ndërhyrjes së zjarrfikseve. Hidrantët duhet të ndodhen brenda filtrit të provës së tymit.

11.3.1 Hidrantë DN 20

Aktivitetet me numër shtretërisht mbi 25 dhe nën 100 duhet të jenë të paktën pajisur me hidrantë DN 20.

Çdo hidrant duhet të jetë pajisur me një tubacion të gjatë 20 m, realizuar sipas rregullave dhe normave në fuqi. Hidrantët duhet të jenë lidhur me një rrjet hidrik normal, sepse kështu mund të mbahet në çdo moment në të njëjtën kohë në përdorim normal, dy hidrantë në pozicione hidraulike të kundërta, sigurojnë në çdo dalje prurje jo më të vogël se 35 l/min, me një presion jo më të vogël se 1.5 bar, kur kemi hyrë në fazën e shkarkimit.

Çdonjëri prej tyre duhet të sigurojë një pavarësi jo më të vogël se 60 minuta. Kur rrjeti hidrik nuk siguron përshkrimet e mësipërme, duhet përdorur ushqim rezervë, me kapacitet të njëjtë aftësie të furnizojë të njëjtin presion.

11.3.2 Hidrantë DN 45

Aktiviteti me kapacitet mbi 100 shtretër duhet të jetë pajisur me hidrantë DN 45. Çdo hidrant duhet të jetë pajisur me një tub freksibël të gjatë 20 m.

11.3.2.1 Rrjeti i tubacionit

Impianti hidrik antizjarr duhet të jetë krijuar nga një rrjet tubacioni, realizuar (preferohet unazë rreth) për montimin për vendosjen në shkallë.

Për çdo montim që i korrespondon çdo kati, duhet të jetë derivat i tubacioneve me diametër të brendshëm, jo më të vogël se 40 mm, një pengesë për hidrantët DN 45.

Rrjeti i tubacionit duhet të jetë i pavarur nga rrjeti hidrant për shërbim sanitar.

Tubacionet duhet të jenë të mbrojtura nga ngrirja, nga zënia e skorjeve metalike, ndaj zjarrit.

11.3.2.2 Karakteristikat hidraulike

Hidranti duhet të ketë karakteristika hidraulike që të garantojë një prurje prej 360 l/min për çdo shtyllë të montuar.

Rrjeti duhet të jetë në gjendje të garantojë të paktën që 3 hidrantë në pozicion hidraulik më të favorshëm, të sigurojë që çdonjëra nga prurjet të mos jetë më pak se 120 l/min, me një presion dalje uji prej 2 bar.

Tubacioni duhet të paktën të sigurojë autonominë prej 60 minutash.

11.3.2.3 Prurja

Impianti duhet të ketë prurje normale furnizimi nga ujësjellësi publik. Kur ky ujësjellës nuk garanton kushtet dhe kondicionet e parashikuara më lart, duhet të realizohet një rezervë hidrike me të njëjtin kapacitet.

Grupi i pompimit të prurjeve të rrjetit antizjarr duhet të jetë realizuar nga elektropompa me ushqim elektrik me rezervë (grup etrogjen ndërhyrës automatik) nga një motorpompë me ndezje automatike.

11.3.2.4 Prurje me shumë besueshmëri

Për aktivitetet akomoduese me më shumë se 500 shtretër dhe për këtë vendosje të objekteve me lartësi antizjarr më të mëdha se 32 m, prurja e rrjetit antizjarr duhet të jetë e tipit me shumë besueshmëri.

Që prurja të konsiderohet me shumë besueshmëri duhet të jetë realizuar me një nga mënyrat e mëposhtme:

- një rezervë potenciale e pashtershme;
- dy sebratorë ose vaska për akumulim, me kapacitet të veçantë të minimumit që kërkon impianti pajisur me rezervë;
- dy këputje ujësjellësi që nuk interferojnë ndërmjet tyre, pra nuk janë prurje të të njëjtit burim, realizuar me mundësi potenciale të pashtershme;

Këto prurje duhet të jenë lidhur në një rrjet antizjarr ndërmjet tyre me dy grupe pompash të përbëra nga një ose më shumë pompa. Çdonjëra nga këto pompa është në gjendje të sigurojë prezencën e kërkuar sipas këtyre kërkesave:

- një elektropompë dhe një motorpompë, njëra rezervë e tjetrës;
- dy elektropompa çdonjëra çon barabartë me gjysmën e nevojës dhe një tjetër motorpompë rezervë, me fuqi hipjeje të barabartë me nevojën e përgjithshme;
- dy motorpompa, njëra rezervë e tjetrës;
- dy elektropompa, njëra rezervë e tjetrës, me prurje elektrike të pavarur.

Çdonjëra nga pompat duhet të punojë automatikisht.

11.3.3 Hidranti DN 70

Në strukturat me veprimtari akomoduese me mbi 500 shtretër të këtyre vendndodhjeve të objekteve me lartësi antizjarr mbi 32 m, duhet asistuar nga jashtë në pozicionin më të arritshëm, në kohën e duhur të sinjalizimit, të paktën një hidrant DN 70 i dobishëm për ndërhyrjen e zjarrfikësve. Këto hidrante duhet të sigurojnë të paktën një prurje jo më të vogël se 460 l/min për të paktën 60 minuta.

Në rastet e të njëjtit rrjet ushqimi që janë dhe hidrantët e brendshëm me ato të jashtëm, prurja e ushqimit duhet të sigurohet të paktën si nevojë me përshtatje me përdorim kompleks.

11.3.4 Lidhja me autopompën automjetit zjarrfikës

Në këmbët e kolonave në hyrje të objektit montohet në pjesët e objektit me më shumë se tre kate mbi tokë, duhet të jetë instaluar një autopompë e tipit të përmasave që përdorin automjetet zjarrfikës.

11.3.5 Impianti i fikjes automatike

Një tjetër rrjet hidranti montohet, në strukturat akomoduese turistike deri në 1000 shtretër, duhet të jetë present impianti i fikjes automatike me shi në të gjithë sipërfaqen e aktivitetit.

12. Impianti i zbulimit dhe sinjalizimit të zjarreve

12.1 Të përgjithshme

Në aktivitetet akomoduese turistike me kapacitet 100 shtretër duhet të jetë parashikuar instalimi i një impianti të ngulur të zbulojë e sinjalizojë automatikisht praninë e zjarreve, i aftë të zbulojë e sinjalizojë në distancë dhe që në fillësë një rrezik që sapo ka ndodhur në ambientet e aktivitetit.

Në ambientet e depozitave magazinë i pavarur nga numri i shtretërve, duhet të instalohet në çdonjë prej tyre këto impiante siç parashikohet në pikën 8.1.

12.2 Karakteristikat

Impiantet duhet të jenë të mbrojtura sipas dispozitave dhe rregulloreve në fuqi.

Sinjalizimi i alarmit duhet të vijë si rezultat i zbulimit, i cili duhet të jetë gjithmonë një sinjalizim pamor (optik) dhe zanor (akustik) i alarmit antizjarr në centralin e komandimit, kontrollit të sinjalizimit, ku ai duhet të jetë vendosur në një vend të dukshëm.

Impianti i sipërcituar duhet të pranojë, lejojë, vënien në lëvizje automatikisht rregullat e alarmit në vend në aktivitete të brendshme:

a) 2 minuta të lëshojë sinjal alarmi si rezultat i dy a më tepër zbuluesish, ose të lëshojë pulsime të njëtrajtshme sinjali antizjarr;

b) 5 minuta të lëshojë një sinjal alarmi si rezultat i zbuluesve ose sinjalizuesve në qendrën e alarmit (central), që nuk duhet të preket nga personat e posaçëm.

Kohët e sipërcituara mund të modifikohen në konsideratë me tipologjinë e aktivitetit dhe të riskut dhe të fikësve të zjarrit.

Kur janë parashikuar rregullat teknike prezente ose mbrojtja e aktivitetit akomodues, impianti i zbulimit duhet të pranojë automatikisht aktivizimin nga një apo më shumë ndikime:

- mbyllja automatike e pengesave eventuale të zjarrit, normalisht të hapura, pjesëve të tyre antizjarr në çdo rast duhet të vijë sinjalizimi në rrugët e kalimit të aktivitetit sipas normave për mbylljen;

- çaktivizimi elektrik i mundshëm i impiantit të ventilatorit ose kondicionerit ekziston;

- aktivizimi i mundshëm i filtrave në mbi presion;

- mbyllja e mundshme e “qepenave” për ndalim zjarri ekzistojnë vende në kanalizimet e impianteve të ventilimit ose kondicionimit, referuar ndarjeve nga vjen sinjalizimi;

- mundësia e transferimit në distancë të sinjalizimit të alarmit në vende të dukshme në një kat operativ të brendshëm të emergjencës;

Në aktivitetet akomoduese me më pak se 300 shtretër ose më shumë se 100 shtretër, vendndodhja në brendësi të ndarjeve në lartësinë mbi 24 m duhet të jetë instaluar sistem optik, që përsërit alarmin në gjatësinë e gjithë koridorit, për zbuluesit vendodhja në kamera e për ruajtje.

Këta zbulues, çdonjëri duhet të jetë parashikuar për të zbuluar dhe treguar hapësirën (zonën) që nuk shihet direkt në mënyrë vizive.

13. Sinjalistika e sigurisë

Sinjalistika e sigurisë duhet të jetë konform akteve dhe normave teknike në fuqi. Pozicioni dhe funksioni i hapësirave të qeta duhet të jetë kategorikisht e sinjalizueshme.

14. Administrimi i sigurisë

14.1 Të përgjithshme

Përgjegjësit e aktivitetit kujdesen që rruga e drejtimit të mos vijë në kundërshtim me kushtet e sigurisë dhe në veçanti në:

- mbi sistemin e rrugëve të daljes nuk janë lidhur pengesa (depozita, mobilje etj) që kanë vështirësuar evakuimin e personave kthen largësinë që e përbën rrezik për paraqitjen e zjarreve;

- mbahen në efikasitet mjetet në impiantet antizjarr dhe janë realizuar në kohën e duhur të mundshme mirëmbajtja e nevojshme e ujësjellësve periodikisht, me rritëm çdo 6 muaj;

- janë rrethana të mundshme të sigurisë në raste të situatave të veçanta, si për shembull: mirëmbajtja, risistemimi etj;

- janë mbajtës të konstatimit në efikasitet impiantet e ventilimit, kondencimit, të ngrohjes. Në rast kontrolli duhet të jetë sinjalizuar siguria antizjarr dhe duhet të jetë parashikuar një provë rreziku i njëjtë me skadimin, jo më larg se 1 vit. Centralet termike duhet të jenë të besueshme dhe të certifikuara kualifikisht, të konfirmuara në bazë të akteve ligjore në fuqi dhe të rregullave teknike ndërkombëtare;

- janë mbajtës konstatimi në efikasitet, impiantet elektrike në konformitet siç është parashikuar në dispozitat në fuqi.

14.2 Thirrja shërbimit të ndihmës

Shërbimi i ndihmës duhet të jetë lajmërim i thjeshtë, me rrjet telefonik. Procedura e lajmërimit duhet të jetë direkte, nëpërmjet aparatit telefonik kur është e mundshme. Në rast të rrjetit telefonik publik, numri i lajmërimit të zjarrfikësve duhet të jetë i vendosur mirë që të shihet qartë në aparaturën e telefonit të shërbimit.

15. Stërvitje mësimore e personelit

15.1 Ndëryrja e parë dhe vënia në lëvizje të sistemit të alarmit

Përgjegjësi i aktivitetit duhet të pranojë me qëllim që, në rastet e zjarreve, personeli të jetë në gjendje të kryejë në mënyrë korrekte me pajisjet të disponueshme operacionin për ndërhyrjen e parë, për më tepër të vërë në lëvizje sistemin e alarmit dhe sistemin e thirrjes së ndihmës.

Këto operacione duhet të jenë të qarta dhe tregues të personave të ngarkuar dhe në formë të shkruar. Personeli i aktivitetit, të paktën 2 herë në vit, duhet të thërritet në mbledhje për përdorim dhe instruksionet e alarmit dhe thirrja e ndihmës, për më tepër për ushtrimin e evakuimit për lëvizjen në kate në emergjenca të mundshme të parashikuara.

15.2 Plani i lëvizjes (zbatimi)

Në rastet e zjarreve, personeli i aktivitetit akomodues duhet të jetë detyruar të zbatojë udhëzimet e lëvizjes:

- aplikimi i instruksioneve që janë shkruar mbi pajisjet;
- kontribuimi efektivisht për evakuimin i të gjithë të pranishmëve në aktivitetin turistik.

15.3 Aktiviteti me kapacitet mbi 500 shtretër

Në aktivitet akomoduese me kapacitet mbi 500 shtretër duhet të jetë parashikuar një shërbim i sigurimit të nevojshëm i organizuar në përbërje të një përgjegjësie të ngarkuar me stërvitjen, për të qënë gati për ndërhyrjen pajisur me ekip të përshtatshëm.

16. Regjistri i kontrolleve

Duhet të jetë parashikuar një regjistër i kontrolleve periodike në dispozicion të veprimtarisë akomoduese, ku duhet të jenë shënuar të gjitha ndërhyrjet dhe kontrollet realisht dhe efektivisht, të impianteve elektrike, ndriçimit, sinjalizimit, sigurisë, të antizjarrit. Dispozitat e sigurisë dhe të kontrollit në zonat me rrezik specifik dhe të vëzhgimit të kufijve të karikimeve antizjarr në këto ambiente të aktivitetit, për më tepër mbledhja e stërvitjes dhe ushtrimit të evakuimit. Këto regjistra duhet të jetë gjithmonë të konstatuara për ditë dhe të dispozitave për kontrollin nga ana e shërbimit zjarrfikës.

17. Instruksioni i sigurisë

17.1 Instruksioni i paraqitur në hyrje

Në hyrje të veprimtarisë akomoduese duhet të jetë ekspozuar mirë në pamje instruktuese relative i pjesëve të objektit për personelin dhe publikun, në rast të shkurtuar dhe të thjeshtë një planimetri e objektit, për skuadrat e shpëtimit të ndihmës që tregojnë pozicione:

- të shkallëve dhe rrugëve të evakuimit;
- të pjesëve të impianteve fikëse disponibël;
- të rregullave të ndalimit të impianteve të depozitave të gazit dhe atyre elektrik;
- rregullave të ndalimit të sistemit të ventilimit;
- kabina qendrore e sistemit të zbulimit dhe të alarmit;
- impiantet e pjesëve të objektit me rrezik specifik;
- të hapësirës së qetë.

17.2 Instruksioni i paraqitur në çdo kat

Në çdo kat duhet të jetë i paraqitur planimetria e orientimit të rrugëve për evakuim. Pozicioni dhe funksionimi i hapësirës së qetë duhet të jetë qartësisht i sinjalizuar.

17.3 Instruksioni i paraqitur në çdo dhomë

Në çdonjërin nga dhomat, në mënyrë preçize vendoset instruksioni, paraqitur në mënyrë të qartë duhet të tregojë pjesët që janë raste për zjarr. Instruksionet duhet të jenë të shkruara në disa gjuhë, ku dominon gjuha e klientelës që frekuenton veprimtarinë akomoduese.

Këto instruksione duhet të jenë shoqëruar nga një planimetri e thjeshtëzuar e katit, ku tregohet skematikisht pozicioni i dhomës respektive, rrugët e evakuimit, të shkallëve dhe të daljeve. Instruksionet duhet të tërheqin vëmendjen për të ndaluar të përdorin ashensorin në rast zjarri.

Gjithashtu duhet të tregojnë ndalim të:

- zënies së vatrave të ndonjë lloji për ngrohje e gatim, stufat dhe aparatet të nxehtësisë ose të ndriçimit, në përgjithësi të funksionimit elektrik me rezistencë në pamje, ose pajisje me mbushje të lendëve të djegshme të gazta.

Mbajtja e depozitave në mënyrë modeste, substancave të djegshme në objekte, pjesë e punës së volumit të destinuar për aktivitetin.

21.1 Dispozita transitorë

Për aktivitetet akomoduese ekzistuese, specifikimet e përshkruara në këtë rregullore hyjnë në fuqi:

a) pas një viti, për sa është parashikuar në përshkrimet e pikave 14, 15 dhe 16;

b) pas dy vjetësh për sa është parashikuar në përshkrimet e pikës 19.2;

c) pas një viti për sa është parashikuar në përshkrimet e pjesës së dytë-aktivitetet akomoduese ekzistuese.

KREU III

DISPOZITA RELATIVE NË AKTIVITETE AKOMODUESE ME KAPACITET JO MË TË MADH SE 25 SHTRETËR

22. TË PËRGJITHSHME

Strukturat horizontale dhe vertikale duhet të kenë rezistencën ndaj zjarrit jo më të vogël se REI 30.

Impiantet duhet të jenë realizuar sipas përcaktimeve maksimalisht të sakta.

Duhet të jetë siguruar për çdo rast eventual emergjence evakuim të sigurt të të pranishmëve, si dhe të ftuarve nga këto ndërtesa, të cilat janë objekt i kësaj rregulloreje.

Duhet të respektohen dispozitat e parashikuara në përshkrimet e pikave 11.2, 13, 14, 17.

11.2 Fikësit e zjarrit

Gjithë aktiviteti akomodues turistik duhet të jetë pajisur në përputhje me numrin e fikësve të lëvizshëm. Fikësit e zjarrit duhet të jenë të harmonizuar dhe të certifikuar konform kritereve të përcaktuara në një nga vendet e Komunitetit Europian.

Fikësit e zjarrit duhet të jenë shpërndarë në mënyrë uniforme në hapësirën për mbrojtje; sidoqoftë të paktën njëri nga fikësit të gjendet:

- përbri pajisjeve që mund të shërbejnë si ndezës zjarri

- afër zonave me potencial rreziku zjarri.

Fikësit e zjarrit duhet të ndodhen në pozicione lehtësisht të arritshme dhe të kapshme, si dhe të shikueshme. Mbishkrimi i udhëzuesit tregues në fiksion e zjarrit duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm në distancë. Fikësit portativë duhet të jenë instaluar në propocion të çdo 200 metrave katrorë të dyshemesë ose pjesë fraksioni me një minimum një fikës për çdo kat.

Fikësit e zjarrit portativë duhet të kenë kapacitet shuarje jo më të vogël se 13 A- 89 B; për mbrojtjen e hapësirave dhe impianteve me rrezik specifik duhet të jenë parashikuar fikës të tipit të përshtatshëm. Për aktivitete akomoduese deri në 25 shtretër është i mjaftueshëm instalimi i një fikësi të vetëm.

13. Sinjalistika e sigurisë

Sinjalistika e sigurisë duhet të jetë konform akteve dhe normave teknike në fuqi. Pozicioni dhe funksioni i hapësirave të qeta duhet të jetë kategorisht e sinjalizueshme.

14. Administrimi i sigurisë

14.1 Të përgjithshme

Përgjegjësit e aktivitetit kujdesen me qëllim që rruga e drejtimit nuk vjen në kundërshtim me kushtet e sigurisë dhe në veçanti në:

- mbi sistemin e rrugëve të daljes nuk janë lidhur pengesa (depozita, mobilje etj) që kanë vështirësuar evakuimin e personave kthen largësinë që e përbën rrezik për paraqitjen e zjarreve;

- janë mbajtur në efikasitet mjetet në impiantet antizjarr, janë realizuar në kohën e duhur të mundshme mirëmbajtja e nevojshme e ujësjellësve periodikisht provë e së njëjtës me rritëm çdo 6 muaj;

- janë rrethanë të mundshme të sigurisë në raste të situatave të veçanta, si për shembull: mirëmbajtja, risistemimi etj;

- janë mbajtës të konstatimit në efikasitet impiantet e ventilimit, kondencimit, të ngrohjes. Në rast kontrolli, duhet të jetë sinjalizuar siguria antizjarr dhe duhet të jetë parashikuar një provë rreziku e njëjtë me skadimin jo më larg se 1 vit. Centralet termike duhet të jenë të besueshme dhe të certifikuara kualifikisht, të konfirmuara në bazë të akteve ligjore në fuqi dhe të rregullave teknike ndërkombëtare;

- janë mbajtës konstatimi në efikasitet, impiantet elektrike në konformitet siç është parashikuar në dispozitat në fuqi.

14.2 Thirrja shërbimit të ndihmës

Shërbimi i ndihmës duhet të jetë lajmërim i thjeshtë, me rrjet telefonik. Procedura e lajmërimit duhet të jetë direkte, nëpërmjet aparatit telefonik kur është e mundshme. Në rast të rrjetit telefonik publik numri i lajmërimit të zjarrfikësve duhet të jetë i vendosur mirë që të shihet qartë në aparaturën e telefonit të shërbimit.

17. Instruksioni i sigurisë

17.1 Instruksioni i paraqitur në hyrje

Në hyrje të veprimtarisë akomoduese duhet të jetë ekspozuar mirë në pamje instruktuese relative të pjesëve të objektit për personelin dhe publikun në rast të shkurtuar dhe të thjeshtë një planimetri e objektit për skuadrat e shpëtimit të ndihmës që tregojnë pozicione:

- të shkallëve dhe rrugëve të evakuimit;
- të pjesëve të impianteve fikëse disponibël;
- të rregullave të ndalimit të impianteve të depozitave të gazit dhe atyre elektrike;
- rregullave të ndalimit të sistemit të ventilimit;
- kabina qendrore e sistemit të zbulimit dhe të alarmit;
- impiantet e pjesëve të objektit me rrezik specifik;
- të hapësirës së qetë.

17.2 Instruksioni i paraqitur në çdo kat

Në çdo kat duhet të jetë e paraqitur planimetria e orientimit të rrugëve për evakuim. Pozicioni dhe funksionimi i hapësirës së qetë duhet të jetë qartësisht i sinjalizuar.

17.3 Instruksioni i paraqitur në çdo dhomë

Në çdonjërin nga dhomat në mënyrë preçize vendoset instruksioni, paraqitur në mënyrë të qartë duhet të tregojë pjesët që janë raste për zjarr. Instruksionet duhet të jenë të shkruara në disa gjuhë, ku dominon gjuha e klientelës që frekuenton veprimtarinë akomoduese.

Këto instruksione duhet të jenë shoqëruar nga një planimetri të thjeshtëzuar të katit, ku tregohet skematikisht pozicioni i dhomës respektive, rrugët e evakuimit, të shkallëve dhe të daljeve. Instruksionet duhet të tërheqin vëmendjen për të ndaluar të përdorin asensorin në rast zjarri.

Gjithashtu duhet të tregojnë ndalim të:

- zënies së vatrave të ndonjë lloji për ngrohje e gatim, stufat dhe aparatet të nxehtësisë ose të ndriçimit në përgjithësi të funksionimit elektrik me rezistencë në pamje ose pajisje me mbushje të lendëve të djegshme, të gazta.

Mbajtja e depozitave, dhe në mënyrë modeste, e substancave të djegshme në objekte pjesë e punës të volumit të destinuar për aktivitetin.

KREU IV KAMPE ALPINE

23. TË PËRGJITHSHME

Në fund të përshkrimeve të rregullave teknike, kampet alpine janë klasifikuar sipas këtyre kritereve:

- kategoria A: që arrihen me rrugë të përshtatshme;

- kategoria B: që arrihen me mjet mekanik për ngjitje në shërbim të publikut, me përjashtim të teleksit (lloj teleferiku për skiatorët);

- kategoria C, D, dhe E: kampe që nuk hyjnë në kategoritë e mëparshme, që vijnë të klasifikuara në funksion të situatës të objekteve me referim të lartësisë, në vazhdim të vështirësisë së hyrjes, për më tepër të përqindjes së sistemit normalisht të adoptuar për furnizim.

Nuk hyjnë në asnjë kategori kampet alpine të fushimit të përkoshëm, duke nënkuptuar me këtë përcaktim ndërtimet modeste të përshtatura për fjetjen e alpinistëve, me kujdesjet e mëposhtme:

- gjithmonë të ruajtura dhe të hapura në vazhdimësi, pa prezencën e ushqimeve dhe pajisjeve të gatimit, por me nevojën e ngushtë për pushim dhe shtrim emergjence.

24. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Pavarësisht nga kategoria së cilës i përkasin, mbrojtja antizjarr në çdo kamp duhet të ketë synim që:

- të ulë rrezikun që mund të vijë nga një zjarr;

- të kufizojë përhapjen e zjarreve dhe tymrave;

- t'u lejojë të gjithë frekuentuesve të dalin të padëmtuar.

Në veçanti duhet të respektohen dispozitat e mëposhtme:

a) burimet e harqeve elektrike: duhet të jenë eliminuar harqet elektrike; duhet të vendoset ndalimi i përdorimit të duhanit, si dhe ndezja e zjarreve, përjashtim mund të bëhet për objektet që do të flitet më poshtë në germën "f";

b) aparaturat e pjekjes: mbi aparaturat e pjekjes (furnela, kuzhina) në afërsi të kampeve që funksionojnë me gaz, cila qoftë fuqia e tyre duhet të jenë instaluar rubineta me valvula, përveç një valvule kryesore të sinjalizuar me përjashtim të kampeve që bën fjalë pika 25, bombola eventuale të gazit duhet të vendosen nga jashtë kampeve dhe pa ndonjë komunikim direkt ndërmjet tyre.

c) depozita të rrezikshme: depozitat me substanca të ndezshme, produktet që marrin flakë lehtë, mbeturinat etj, duhet të jenë vendosur nga jashtë kampeve ose lokaleve të ndara pa komunikim direkt;

d) portat e daljeve: nga portat e daljeve duhet të jenë eliminuar mbylljet me çelës nga brenda, dispozitivët me shul me rëshqitje, ose të ngjashme me to, duke garantuar hapjen me ngritjen e dorezës nga brenda, mbyllja eventuale mund të vijë vetëm nga jashtë, në rastin në periudhat e pushimeve të këtij aktiviteti; në rastet kur në kushtet e rënies të dëborës bëhet e nevojshme, që portat e eksodit të vendosura nga jashtë mund të hapen nga brenda;

e) zgarat e hekurit: zgarat e hekurit ose çdo lloj mbrojtëse tjetër fikse e dritare, që nuk lejon përdorimin si rrugë eksodi emegjence në të njëjtën mënyrë (njëlloj), gjithashtu hapja ndaj ndihmave duhet eliminuar;

f) lokale të përshtatura për gatim ushqimesh: edhe nga ana e të ftuarve duhet të jenë të mbrojtura nga mure të paktën deri në lartësinë 150 cm nga toka, dhe mbi dyshemetë të paktën rezja 100 cm rreth e qark vendit ku do të jetë zjarri me flakë të lirë, me materiale të reaksionit ndaj zjarrit të klasës 0; largësia në zonat e mbrojtura nuk duhet të zgjatet për të njëjtat reze prej 100 cm;

g) burime të nxehtësisë: për qark stufave me reze të paktën 1 m lartësi dhe largësi duhet të jenë vendosura mbrojtje të padjeshme; kanalet e tymit nëpër brendësi ose në afërsi të materialeve të djegshme duhet të jenë të mbrojtur duke evituar që të kenë kontakt me temperaturat, në gjendje të mos provokojnë hark elektrik me veten; për operacionin e tharrjes së robave duhet të jenë parashikuar vende të posaçme ose mbështetëse fikëse në distancë të përshtatshme nga burime të nxehtësisë, ku evitohet mundësia e ndezjes (harkut elektrik);

h) dispozitivat e thirrjeve: ku nuk është present ose disponibël për emergjencë, një aparat telefonik duhet të jetë instaluar në pozicion të dukshëm e të mbrojtur një aparat radio thirrje me ushqim të pavarur, mbajtëse fikëse në mënyrë që të çojë automatikisht lajmërimin për shpëtim (njoftimin e ndihmës për një periudhë jo më të vogël se 2 orë, e diferencuar në bazë të tipit të ndërhyrjes së kërkuar dhe kodifikuar për identifikimin dhe individualizim;

i) pajimet e emergjencës: kur kuotat e kampit i kalojnë të 1200 m mbi nivelin e detit dhe për kuota më të ulëta, kushtet metereologjike lokale që mund të prezantohen e paraqiten janë të afrueshme me ato të këtyre kuotave, duhet të jetë e pranishme qesja e emergjencës. Ky disponibël i vulosur përbëhet nga një pëlhurë e aluminiuar në formë thesi të përshtatshëm (të aftë) të përmbajë një alpinist. Thasët e emergjencës në numër të barabartë sa kapacitetet maksimale të kampit të rritura me 20 %, duhet të jenë të ruajtura në një vend të veçantë, qartësisht të shenjuara ku janë parashikuar tregues të qartë për përdorimin e tyre, të vendosura në një distancë nga kampi në mënyrë të tillë që të mos përfshihet nga zjarret eventuale;

j) skeda teknike: nën kujdesin e titullarit të aktivitetit duhet të redaktohen skedat teknike, që tregojnë karakteristikat e çdo kampi me qëllim primar atë të mbrojtjes nga zjarri, në të cilat duhet të shënohet emri, mbiemri i administratorit dhe përgjegjësi i aktivitetit; përgjegjësi i sigurimit duhet të procedojë të paktën një herë në vit me kontroll të përgjithshëm të situatës të pajimeve të parashikuara dhe efikasitetin e pajisjeve.

25. KAMPE ME KAPACITET JO MË TË MADH SE NJËZET E PESË SHTRËTËR

Kampet alpine të çdo kategorie, me kapacitet jo më të madh se 25 shtretër, duhet të respektojnë sa është parashikuar në gerमत e mëposhtme:

a) strukturat horizontale dhe vertikale të kampeve me konstruksione të reja duhet të posedojnë karakteristika të rezistencës ndaj zjarrit jo më të vogla se R 30. Këto përshkrime nuk aplikohen për kampet ekzistuese;

b) duhet të kryhen prova periodike të paktën me frekuencë vjetore duke respektuar përshkrimet e pikës 24;

c) lejohet mbajtja në brendësi të lokaleve një bombul GLP, me peshë që të mos i kalojë 25 kg, me qëllim që kjo të përdoret për ushqimin e pajisjeve të gatimit;

d) duhet të jenë instaluar fikësa zjarri konform sa është përshkruar në kërkesat e pikës 11.2.

26. KAMPE ME KAPACITET MË TË MADH SE NJËZET E PESË SHTRËTËR

26.1 Kampe të kategorisë A

Kampet alpine të kësaj kategorie aplikohen në bazë të faktit, nëse janë të reja ose ekzistuese, dispozitat për të cilat bën fjalë pjesa e parë dhe e dytë të kapitujve të kësaj rregulloreje.

26.2 Kampe të reja të kategorive B, C, D, E

Për kampet e kësaj kategorie vlejnë të njëjtat dispozita të kapitullit II të pjesës parë, por duhet vërejtur që:

- nuk janë respektuar përshkrimet e pikëve 5.3 dhe 5.4 dhe janë të disponueshme përveç të tjerash të paktën shkallë të vogla në gjendje për të shkuar në të gjithë katet e ndërtesës; për lartësi 6 m shkallët duhet të jenë fikse; vendodhja e shkallëve duhet të jetë e treguar qartë e dukshëm për të treguar një përdorim të thjeshtë dhe të lehtë nga ana e të ndihmuarve;

- frekuenca e provave periodike për të cilat bën fjalë pika 14.1, duhet të jetë të paktën njëvjeçare;

- për kampet e kategorisë C, D dhe E deri në dy kate mbi tokë është lejuar që numri i daljeve të jetë një, për çdo kat.

26.3 Kampe ekzistues të kategorisë B

Për të tilla kampe vlejné dispozitat e përshkruara në kapitullin II pjesa e dytë. Gjithashtu kërkohet që:

- të jenë të disponueshme shkallë të kryqëzuara në gjendje për të arritur katet e ndërtesës; për lartësi mbi 6 m, shkallët duhet të jenë fikse; vendodhja e shkallëve duhet të jetë treguar qartë për një përdorim të thjeshtë nga ana e personave që kërkojnë ndihmë;

- që të ketë për çdo ndërtesë më shumë se dy kate mbi tokë dhe për çdo kat një dalje të dytë eksodi, që të garantojë shpërndarimin e nevojshëm.

Është e lejuar gjithashtu:

a) rezistenca ndaj zjarrit të këtyre strukturave, pavarësisht nga ngarkesa e zjarrit dhe lartësia e ndërtesës të jetë jo më e vogël se REI 30;

b) nuk aplikohen përshkrimet në lidhje me ndarjet me karakteristika të rezistencave ndaj zjarrit midis korridoreve dhe dhomave, për të cilat bën fjalë pika 19.5;

c) shkallët duhet të jenë të tipit të mbrojtur në ndërtesat me tre kate mbi tokë;

d) gjerësia minimale e rrugëve të eksodit nuk duhet të jenë më të vogla se 60 cm, pa reduktimet e tolerancave dimensionale, llogaritur për një kapacitet fluksi të paktën për 30 persona; për gjerësi të barabartë ose më të mëdha se 90 cm, pranohet sa është përshkruar në pikën 20.2;

e) rrugët e daljes, referuar sa më sipër janë të ndërtuara nga shkallë të kryqëzuara të realizuara nga materiale jo të djegshëm të vendosura nga jashtë kampeve, të ankoruara në mënyrë solide me karakteristikat minimale: gjerësi jo më të vogla se 35 cm në pjesën e kryqëzimit, lartësia neto jo më e madhe se 30 cm dhe me kryqëzues, kryqëzime të larguara të paktën 15 cm nga paretet; shkallë të tilla duhet të jenë të arritshme nëpërmjet kafazëve të hapshëm të dimensioneve neto, jo më të vogla se 60 cm gjerësi, si dhe 80 cm lartësi; çdo shkallë me kryqëzimin duhet të jetë e llogaritur për një kapacitet daljeje fluksi të barabartë për 20 persona; shkallë të tilla duhet të jenë realizuar konform normave antiaksident dhe gjithashtu duhet të parashikojnë parrakë të vazhduar për të paktën 30 cm, nga filli i kryqëzimit; për lartësi të shkallëve të kryqëzuara më të larta se 10 cm duhet të jetë parashikuar një shesh pushimi të paktën 70 cm, me zgjatje dhe 50 cm me parapet normal dhe ndalues këmbësh, nga e cila është e mundur të marrësh distancën për në një shkallë tjetër më të afërt;

f) dispozitivët e ndriçimit të sigurisë dhe të alarmit ushqehen, kur nuk disponohet energji elektrike nga një burim tjetër alternativ, grup elektrogjen, gjenerator ere, gjenerator me diell etj;

g) në pamundësi për të realizuar një impiant hidrik antizjarr për mungesë të burimeve hidrike të përshtatshme, përshkrimet e pikës 11.3 zëvendësohen të paktën me fikësa me kapacitet 13 A dhe 89 BC për çdo 50 m² dhe sidoqoftë me një fikës për çdo kat;

h) frekuenca e provave periodike, që bën fjalë pika 14.1, të jetë të paktën njëvjeçare.

26.4 Kampe ekzistuese të kategorive C, D dhe E

Në të tilla kampe aplikohen përshkrimet e pikës pararendëse 26.3, me përjashtim sa kërkohet nga pikat "a" dhe "c".

Është lejuar gjithashtu që kur nuk ka ushqim elektrik, ndriçimi i sigurisë të jetë me llampa të lëvizshme me ushqim automatik dhe sisteme alarmi, që vihen në punë në mënyrë manuale.

27. DISPOZITA TRANZITORE

Kampet alpine ekzistuese duhet të përshtaten me këto dispozita të pranishme në këtë rregullore, brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e saj.

URDHËR

Nr.481, datë 9.11.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR.98, DATË 26.2.2004 “PËR TARIFAT E TË ARDHURAVE DYTËSORE, TË APLIKUESHME NGA INSTITUCIONET VARTËSE TË SISTEMIT TË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të pikës 13 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.532, datë 31.10.2002 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki”, me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Tokave,

U R D H Ë R O J:

Pika IX, germa “b” e urdhrit nr.98, datë 26.2.2004 “Mbi tarifatat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të sistemit të bujqësisë dhe të ushqimit”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI
Agron Duka**

URDHËR

Nr.482, datë 9.11.2004

PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE QË KRYHEN NGA SEKSIONET E ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS NË QARK

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe pikës 13 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.532, datë 31.10.2002 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komunë dhe ose bashki”, me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Tokave,

URDHËROJ:

1.Tarifatat e shërbimeve që do të kryhen nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark do të jenë:

- Vërtetim pronësie para vitit 1946	1000 lekë
- Vërtetim pronësie pas vitit 1946	5000 lekë
- Vërtetim negativ para reformës, për në gjykatë	500 lekë
- Vërtetim pronësie për Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	500 lekë
- Vërtetim pronësie që kërkohet për Statusin të pastrehë	200 lekë
- Konfirmim i vërtetimeve për ndihmë ekonomike e përkrahje sociale të ardhura nga komuna dhe/ose bashkia	100 lekë

- Konfirmim i formularit nr.5 bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.560 500 lekë
 - Harta e skica planimetricke – kadastrale 1000 lekë
 - Vërtetime për kategorizimin e tokës, sipas bonitetit 2000 lekë
 - Dublikatë e aktit të marrjes së tokës në pronësi ose në përdorim 500 lekë
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Agron Duka

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
15.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-2004 **1500**

Doli nga shtypi më 18.11.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë